


REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
UNEP

Konsulence

për

“NDËRTIMI PËR RIKUPERIMIN E LAGUNËS KUNE-VAIN NËPËRMJET PËRSHTATJES TË BAZUAR NË EKOSISTEM (EBA)” (FONDI I VEÇANTË PËR NDRYSHIMIN E KLIMËS), i fokusuar në:

- i) Përditësimin e kornizës logjike të projektit duke vlerësuar dhe rishikuar indikatorët dhe targetet, kundrejt të cilave do të vlerësohen ndikimi dhe performanca e projektit; dhe**
- ii) Kryerjen e vëzhgimeve bazë për të themeluar informacionin bazë për këto indikatorë.**



RAPORTI FINAL – VËZHGIMI BAZË – PROJEKTI PËR RIKUPERIMIN E LAGUNËS KUNE VAIN - SHQIPËRI

Nëntor, 2017



CEIA

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**

PROGRAMI I KOMBEVE TË BASHKUARA PËR MJEDISIN

Shërbim konsulence për

Vëzhgimi Bazë – Projekti për Rikuperimin e lagunës Kune-Vain

Reporti final – I rishikuar

Studio Konsulente – Qendra për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

Nëntor 2017, Tiranë, Shqipëri



Qendra për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

**Përgatiti: Roxhensa Kreci
Kontrolloi: Spartak Sinojmeri**

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

Tabela e Përmbajtjes

1	Përmbledhje e Raportit.....	6
2	Parathënie.....	10
3	Përshkrimi i projektit.....	12
3.1	Fondi i Veçantë për Ndryshimin e Klimës dhe EbA.....	13
3.2	Rëndësia Globale	14
3.3	Komponentët e Projektit	15
4.1	Përshkrimi i Vëzhgimit	19
4.2	Studimi bazë – Vlerësimi i vulnerabilitetit	27
4.2.1	Metodologjia e vlerësimit të vulnerabilitetit	27
4.3	Rezultatet e Vlerësimit të Vulnerabilitetit	32
4.3.1	Rezultatet e Indeksit të Vulnerabilitetit për KVT	33
4.4	Studimi bazë – Metodologjia e vlerësimit	36
4.5	Vlerësimi i Indikatorëve dhe targeteve.....	38
4.6	Rezultatet e vlerësimit të indikatorëve dhe targeteve	44
5	Versioni i përditësuar i Kornizës të Rezultateve	75
6	Startegjia për monitorimin e indikatorëve të projektit	89
7	Mangësia e të Dhënave dhe Metodologjia për mbledhjen e të dhënave të munguara.....	106
8	Konkluzione.....	108

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

Lista e figurave

Figura 1.	Shpendë të rëndësishëm në zonën e Vainit.	12
Figura 2.	Shpendë të rëndësishëm në zonën e Vainit	12
Figura 3.	Harta e territorit të parcelave të zgjedhura për ripyllëzim, lidhur me statusin e mbrojtjes (zonimin) të Zonës të Mbrojtur Kune Vain Tale. E përpunuar në hartën bashkëngjitur VKM 432, viti 2010, për miratimin e Planit të Menaxhimit Kune Vain Tale.....	Error! Bookmark not defined.
Figura 4.	Pamje e territorit që do të mbillet me <i>Ammophila arenaria</i> (barishte bregdetare) dhe <i>Tamarix sp.</i> (shkurre rezistente ndaj ujit dhe kripës).....	Error! Bookmark not defined.
Figura 5.	Foto satelitore e kanalit që do të rihapet.....	Error! Bookmark not defined.
Figura 6.	Korniza e Vulnerabilitetit – komponentët dhe indikatorët	Error! Bookmark not defined.

Lista e Grafikëve

Grafiku 1.	Përqindja e të intervistuarve sipas grup-moshës.	21
Grafiku 2.	Niveli i edukimit sipas gjinisë.....	22
Grafiku 3.	Statusi i punësimit sipas gjinisë (komuniteti, fshatrat dhe Tirana,Lezha).	22
Grafiku 4.	Përdorimi i kulturave bujqësore	24
Grafiku 5.	Mesatarja e ndërgjegjësimit për ndryshimet klimatike dhe EbA, sipas gjinisë.....	24
Grafiku 6.	Ndryshimet e klimës të vërejtura në 5 vitet e fundit.....	25
Grafiku 7.	Mesatarja e indeksit të ekspozimit	33
Grafiku 8.	Mesatarja e indeksit të ndjeshmërisë	34
Grafiku 9.	Mesatarja e indeksit të kapaciteteve të përshtatjes	34
Grafiku 10.	Ndërgjegjësimi për ndryshimet klimatike sipas fshatrave dhe vlera mesatare e ndërgjegjësimit	35
Grafiku 11.	Mesatarja e indeksit të Vulnerabilitetit	35

Lista e Tabelave

Tabela 1.	Shpërndarja gjeografike dhe territoriale e pyetësorëve.....	21
Tabela 2.	Statistika deskriptive mbi statusin e punësimit, burimet e jetesës, burimin kryesor të ujit, etj.....	24
Tabela 3.	Rezultatet e vlerësimit të vulnerabilitetit. Përbërësi i Indikatorit, njësia e matjes dhe pikët	31
Tabela 4.	Indeksi i ndërgjegjësimit ndaj Ndryshimeve Klimatike – Përbërësit e Indikatorëve, njësiti e matjes, pyetja ekzakte dhe vlerësimi me pikë	33
Tabela 5.	Konsiderata të vlerësimit të indikatorëve	39
Tabela 6.	Vlerësimi i indikatorëve bazuar në metodologjinë SMART (me “N” dhe gërma të kuqe indikatorët janë vlerësuar si jo të përshtatshëm, me “M” dhe gërma blu janë treguar ato që janë të përshtatshëm por që nevojiten disa ndryshime në cilësinë dhe/ose sasinë e tyre dhe me “Y” dhe ngjyrë të zezë janë paraqitur indikatorët e duhur.).....	43
Tabela 7.	Nismat ndërsektoriale që marrin në konsideratë ndryshimet Klimatike dhe EbA.....	49
Tabela 8.	Përshkrimi i indikatorëve ekzistues dhe të rekomanduar, vlerat bazë dhe targetet	74
Tabela 9.	Korniza e rezultateve të rekomanduara për vëzhgimin bazë	88
Tabela 10.	Strategjia e Monitorimit.....	105

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpëmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpëmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

AKRONIME DHE SHKURTIME

NK	Ndryshimet Klimatike
QVNM	Qendra për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
EbA	Përshtatja e bazuar në Ekosistem
KE	Komisioni European
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
PMM	Planet e Menaxhimit Mjedisor
PMSM	Planet e Menaxhimit Sociale dhe Mjedisore
BE	Bashkimi European
EUR	Euro
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
QSH	Qeveria e Shqipërisë
Ha	Hektar
IBA	Zonë e Rëndësishme e Zogjve
INSTAT	Instituti i Statistikave të Shqipërisë
PNNK	Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike
ISRBC	Komisioni Ndërkombëtar i Pellgut të Lumit Sava
IUCN	Bashkimi Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës
IWRM	Menaxhimi i Burimeve të Integruara Ujore
KVT	Kune Vain Tale
ZMKVT	Zona e Mbrojtur Kune Vain Tale
SMKVT	Stafi i Menaxhimit të Zonës Kune Vain Tale
PMAT	Projekti i Menaxhimit dhe Administrimit të Tokës
m ³	Metër Kubik
m ³ /vit	Metër kubik në vit
MBZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave
MM	Ministria e Mjedisit
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NA	Jo e Aplikueshme
NAP	Plani Kombëtar i Përshtatjes
OJF	Organizatata Jo – Qeveritare
Nr	Numër
NSDI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
ABU	Agjensia e Baseneve Ujore
KBU	Këshilli i Basenit Ujor
PMBU	Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor
DRZM	Drejtoria Rajonale e Zonave të Mbrojtura
SCCF	Fondi i Veçantë për Ndryshimet Klimatike
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
SIDA	Agjensia Suedeze e Zhvillimit Ndërkombëtar
ToR	Termet e Referencës
t/ha/vit	Ton për Hektar në Vit
UN	Kombet e Bashkuara
UNDP	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpëmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

UNEP	Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara
WB	Banka Botërore
WFD	Direktiva në Kuadër të Ujit
SLKV	Sistemi Lagunor Kune Vain

1 Përmbledhje e Raportit

Zona e Mbrojtur Kune Vain Tale është e vendosur në bregun e detit Adriatik, në Shqipëri. Mungesa e planeve të efektshme për ndërhyrjet e përshtatje nga ana e njeriut ndaj ndikimeve aktuale dhe atyre të pritshme të shkaktuara nga ndryshimeve klimatike në Zonën e Mbrojtur, po shkakton probleme serioze në përsa i përket përqëndrimit të ekonomisë, vlerave sociale dhe natyrore të zonës. Kjo është arsyeja e mobilizimit, të projektit të Fondit të Veçantë për Ndryshimin e Klimës, me qëllim që të rriten kapacitetet qeveritare dhe të komuniteteve lokale që jetojnë pranë SLKV ndaj ndryshimeve klimatike, duke përdorur një komplet të integruar të ndërhyrjeve të përshtatjes, duke përfshirë EbA, e cila konsiderohet të jetë me kosto më të efektshme në terma afatgjatë kundrejt masave të infrastrukturës. Projekti i SCCF për Rikuperimin e Kune Vain-it është konsideruar si një projekt pilot që do të përdoret si bazë për projektet e EbA, në të ardhmen. Projekti për Rikuperimin e Kune Vain-it përbëhet nga tre komponentë plotësues:

- Përmirësimi i kapaciteteve teknike dhe institucionale të politikave dhe vendim-marrësve në Shqipëri për adresimin e rreziqeve të ndryshimeve klimatike, nëpërmjet zbatimit të ndërhyrjeve për përshtatje, përfshirë përshtatjen e bazuar në ekosistem(EbA);
- Demonstrimi i ndërhyrjeve të planifikuara të përshtatjes në SLKV, sikurse përmenden edhe më poshtë:
 - a) Hapja e kanalit të komunikimit midis Detit Adriatik dhe lagunës së Vain-it (laguna e Cekës). Ky lloj aktiviteti do të përmirësojë cilësinë e ujit të lagunës dhe do të rrisë biodiversitetin (shtimin e peshkut), si dhe do të ndihmojë komunitetin që jeton aty pranë (jetesa e të cilëve varet nga peshkimi dhe turizmi) të sigurojnë përfitime më të mira ekonomike, duke përmirësuar në këtë mënyrë standartin e tyre të jetesës. Bazuar në projektin teknik dhe VNM e lidhur me të, ky aktivitet do të zhvillohet pjesërisht. Hapja e kanalit të komunikimit është konsideruar si aktivitet i përshtatshëm, por ndërtimi i dallgëthyesit (që përfshihet në masat e forta për mbrojtjen e bregdetit) me kosto jo efçente do të shkaktojë probleme serioze në fragmentimin e habitateve ujore bregdetare dhe nxitjen e erozionit në zonat aty pranë. Prandaj Vëzhgim Bazë rekomandoi ndryshime të indikatorit përkatës për këtë aktivitet.
 - b) Ripyllëzimi i 7 ha pyje të degraduara, të cilët do të përmirësojnë në të ardhmen, statusin e biodiversitetit dhe do të rikuperojnë habitatin.
 - c) Stabilizimi i dunave (kontrolli i erozionit) duke mbjellë shkurre dhe barishte autoktone, në një sipërfaqe prej 2 ha.
- Rritja/përmirësimi i ndërgjegjësimit dhe njohurive të komunitetit lokal dhe palëve të interesuara në nivel kombëtar mbi efektshmërinë e EbA.

Të gjitha ndërhyrjet janë konsideruar si zëra mjedisore, dhe promovimi i ndërhyrjeve EbA është konsideruar si një nga veprimet më të efektshme, për tu përgjigjur ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

Qendra për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis u kontraktua për realizimin e Vëzhgimit Bazë, për Projektin e Rikuperimit të Lagunës Kune Vain. Metodologjia e Vëzhgimit Bazë është paraqitur në kapitullin 4. Ky studim është bazuar në një vlerësim bazë, i cili ka vlerësuar vulnerabilitetin e zonës, indikatorët dhe targetet, strategjia e monitorimit të indikatorëve të projektit si dhe ka përcaktuar mangësitë e të dhënave. Vizitat në terren dhe verifikimet, intervistat me palët e interesuara lokale/rajonale dhe

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

kombëtare, intervistat me përfaqësues të institucioneve studimore, kërkimore/shkencore, analizimi i të dhënave dhe vlerësimi i indikatorëve dhe targeteve kanë qënë instrumentet kryesore për përdorimin e metodologjisë të zgjedhur, për zbatimin e projektit. Intervistat e kryera u fokusuan kryesisht në komunitetin dhe palët e interesuara në tre fshatrat përreth SLKV; Ishull-Shëngjin, Ishull-Lezhë dhe Barbullojë, si dhe në qytetin e Lezhës dhe Tiranës. Gjithsej u kryen 128 intervista me familjet, 69 prej të cilave u kryen në tre fshatrat përreth zonës të mbrojtur Kune Vain, 29 intervista në qytetin e Lezhës dhe 30 intervista në Tiranë.

Identifikimi i famijeve dhe palëve të interesuara u bazua në fazën e para-përzgjedhjes, nëpërmjet mbledhjes të informacionit në terren dhe zyrat qeveritare lokale. Informacion u grumbullua edhe për banorët përreth zonës të mbrojtur, mundësisht të cënuar nga ndikimet e ndryshimeve klimatike. Gjithashtu, u kryen edhe intervista rastësore në mënyrë që të vlerësohej më mirë perceptimi i të intervistuarëve ndaj njohurive për ndryshimet klimatike dhe EbA.

Një kategori pyetjesh të bazuara në studime bazë ekzistuese u përdorën për të mbledhur informacion për institucionet administrative lokale, rajonale dhe kombëtare, institucionet kërkimore/shkencore, etj. Pjesa e parë e vlerësimit bazë është vlerësimi i vulnerabilitetit, duke marrë në konsideratë ekspozimin, ndjeshmërinë dhe kapacitetin e përshtatjes. Metodologjia e vlerësimit është paraqitur në kapitullin 4. Shumica e të intervistuarëve kishin vërejtur ndryshime në klimë gjatë 5 viteve të fundit, si; rënie në sasinë e rreshjeve vjetore, asnjë ndryshim në sezonin e shirave, rritje të temperaturës dhe thatësi dhe ngjarje më të shpeshta nga përmytjet.

Nga një maksimum i pikëve të indikatorit prej 12 pikë, fshati Ishull-Lezhë kishte mesataren më të lartë të indeksit të ekspozimit prej 3.43 pikë krahasuar me dy fshatrat e tjerë të përfshirë në këtë vëzhgim. Nga një maksimum prej 14 pikë, të indikatorit, fshati Barbullojë kishte mesataren më të lartë të indeksit të ndjeshmërisë, përkatësisht 4.03, kjo për shkak të ndikimeve dyfish më të mëdha të përmytjeve që vijnë nga laguna apo nga deti, por edhe nga kanali kryesor i kullimit në Tale. Mesatarja e indeksit të ndjeshmërisë për familjet e intervistuar në tre fshatrat përreth Zonës të Mbrojtur Kune Vain, të ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga efektet e ndryshimeve klimatike ishte përkatësisht 3.89. Mesatarja e indeksit të kapacitetit të përshtatjes për komunitetin, në tre fshatrat ku u realizuan intervistat ishte 0.39. Vëzhgimi i ndërmarrë nga konsulentit tregoi qartë se komuniteti përreth Zonës të Mbrojtur nuk kishte eksperiencë apo njohuri të duhura për zbatimin e masave të përshtatjes, për të rikuperuar problemet apo ndikimet e shkaktuara nga ndryshimet klimatike.

Mesatarja e indeksit të ndërgjegjësisë për ndryshimet klimatike ishte 37 %, nga një maksimum i mundshëm 100%.

Në përgjithësi vulnerabiliteti ishte i lartë në të tre fshatrat ku u realizuan intervistat. Mesatarja e vulnerabilitetit rreth zonës ku do të kryen ndërhyrjet e projektit ishte 12.09.

Vëzhgimi bazë është bazuar në vlerësimin e indikatorëve dhe targeteve duke marrë në parasysh vlerësimin e të dhënave të reja, të mbledhura, sikurse edhe vlerat bazë ekzistuese origjinale. Metodologjia e vlerësimit u bazua në kritetet e kombinuara të Fondit të Përshtatjes dhe metodologjinë SMART. Vlerësimi sipas gjinisë ishte gjithashtu, në fokus të studimit. U përgatit edhe një tabelë përmbledhëse vlerësimi, që tregon indikatorët dhe outputet origjinalë, po ashtu edhe ndryshimet e rekomanduara për secilin nga outputet e projektit, sipas nevojës. Shumica e indikatorëve dhe targeteve rezultuan si të përshtatshëm, por me disa përjashtime.

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

Mbas verifikimit të secilit indikator dhe targetit të lidhur me të, në bazë të outcome-ve dhe outpute-ve të lidhura me to, rezultoi se: Indikatori 2.1.1, hapja/rihapja e 10 puseve artezianë nuk mund të realizohet. Kjo vjen si rezultat i ndryshimit të vetive fizike të ujrave nëntokësorë gjatë mbishfrytëzimit të të tyre për qëllime të ujitjes, për larje apo për ujë të pijshëm.

Studimi rekomandoi se Indikatori 2.1.2 duhet të përditësohet, duke reduktuar sipërfaqen që do të mbillet, nga 10 ha (që është planifikuar) në 7 ha. Ndryshimi i propozuar përsa i pëket territorit që do të mbillet është konsideruar nga konsulenti i projektit të mbjelljeve, si i vetmi territor i mundshëm, i përshtatshëm për një mbjellje të efektshme.

Konsulenti i Grupit Inxhinierik, i kontraktuar për projektimin e kanalit të komunikimit arriti në konkluzion se ndërtimi i dallgëthyesit për të kontrolluar sedimentimin në trupin e lagunës është shumë i kushtueshëm. Nga ana tjetër, konsulenti i VNM të projektit në fjalë thekson se ndërtimi i dallgëthyesit nuk është i përshtatshëm nga pikëpamja ekologjike. Ata shpjegojnë se: të tilla ndërtime mund të nxitin erozionin në zonën përreth kanalit, po ashtu edhe do të krijojnë barriera artificiale për gjallesat e ujrave detare, si dhe fragmentizim të habitatit. Prandaj është propozuar që indikatori 2.1.3 duhet të ndryshohet në: hapja e kanalit të komunikimit, pa dallgëthyes.

Grupi Teknik i Mbajlljeve ka propozuar që Indikatori 2.1.4 i cili konsiston në: mbjelljen e 2 ha duna me barrishte autoktone duhet të ndryshohet. Ky indikator është propozuar të ndryshohet në: mbjellje e 2 ha territor me barrishte dhe shkurre autoktone, të përshtatshme për folelizimin e gjallesave të veçanta, si dhe për stabilizimin e dunave në pjesën e brendshme të lagunës, po ashtu edhe në duna.

Është rekomanduar që targeti 2.2.2, i cili konsiston në përgatitjen e të paktën 6 raporteve teknike duhet të ndryshohet për arsye të afatit kohor të mbetur, të projektit. Targeti i propozuar është ndryshuar për ta bërë atë më të efektshëm, më të saktë dhe brenda kufijve kohorë. Në këtë mënyrë është rekomanduar që të prodhohen, të paktën 4 raporte teknike (nga dy për secilin nga 2 vitet e mbetur të projektit).

Targeti 2.3.1, që propozon trajnimin e të paktën 250 anëtarëve të komunitetit lokal për ndërhyrjet e EbA dhe mënyrat tradicionale të jetesës është ndryshuar në: trajnimi i të paktën 50 anëtarëve të komunitetit lokal. Ky ndryshim (reduktimi i numrit të personave që do të trajnohen deri në fund të projekti) është rekomanduar duke marrë në konsideratë se, do të ishte më e përshtatshme të trajnohen 50 trajnierë, anëtarë të komunitetit lokal, të cilët do të trajnojnë në të ardhmen bashkëqytetarët. Një politikë e tillë do të ndihmojë gjithashtu për të realizuar aktivitete trajnimi më të fokusuar dhe më realë, me komunitetin. Kjo do të shmangë nga ana tjetër shpërndarjen formale të çertifikatave të trajnimit, që sikurse e kanë treguar dhe eksperiencat e mëparshme në Shqipëri, trajnime të tilla kanë jo shumë eficientë. Në këtë mënyrë, pjesëmarrja në trajnim e 20 % të numrit të rekomanduar, të anëtarëve të komunitetit duket mjaft reale.

Gjithashtu, ndryshime janë propozuar për targetin 2.3.3. Trajnimi i jo më shumë se 20 anëtarëve të komunitetit lokal, në vend të trajnimit të 50 anëtarëve të komunitetit sikurse është propozuar në Vëzhgimin bazzë origjinal, për të njëjtat arsye si edhe më sipër.

Ndryshime janë bërë edhe për indikatorin e propozuar 3.3.2: Numri i Studentëve MSc dhe PhD që kanë ndërmarrë projekte studimore/kërkimore, si dhe targeti përkatës, targeti 3.3.2; Nga - Të paktën 2 studentë MSc dhe 2 studentë PhD të kenë ndërmarrë projekte studimore/kërkimore është ndryshuar në: Të paktën 4 studentë MSc kanë ndërmarrë projekte studimore/kërkimore në aspektin e ndikimeve socio-ekonomike dhe mjedisore të zbatimi të ndërhyrjeve EbA deri në fund të projektit. Ndryshimi është propozuar për arsye sepse targeti është gjysëm i arritshëm, për shkak të ndërprerjes të përkohshme të programit të studimit PhD nga Ministria e Arsimit, me argumentin se universitetet publike në të gjithë vendin do ti nënshtrohen procesit të akreditimit.

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

Për të lehtësuar vlerësimin e Vëzhgimeve Bazë në të ardhmen, për të njëjtin projekt, shkrirja e disa është konsideruar mjaft e dobishme. Të gjitha ndryshimet janë përmbledhur në tabelën e re, të rishikuar të Kornizës të rezultateve të përditësuara.

Strategjia e monitorimit afatgjatë fokusohet në:

- a) Monitorimin e vazhdueshëm: që bazohet në monitorimin e vazhdueshëm të indikatorëve dhe targeteve, raporteve dhe të dhënave administrative, në të cilat janë paraqitur aktivitetet e monitorimit, përgjegjësitë dhe indikatorët;
- b) Monitorimi dy vjeçar dhe të dhënat administrative: ku janë paraqitur të njëjtat udhëzime si dhe për monitorimin e vazhdueshëm, dhe
- c) Fundi i monitorimit të projektit: ku raportet e monitorimit dy vjeçar dhe workshop-et e lidhura me projektin kanë nxjerrë përfundimin, bazuar në mësimet e mësuara.

Raporti paraqet edhe mangësitë e të dhënave, të identifikuar gjatë Studimit Bazë dhe mënyrat e rekomanduara për të përmirësuar statusin e tyre. Probleme të tjera janë të identifikuar gjatë studimit dhe disa pret të cilave që duhet të përmenden, janë si më poshtë: vështirësi për intervizitimin e personave të gjinisë femërore, për shkak të mentalitetit të familjeve, të cilat ishin pjesë shumë e rëndësishme e qëllimit të projektit, për zhvillimin dhe zbatimin e strategjive përshkallëzuese dhe udhëzimeve të EbA në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar, etj. Niveli i njohurive dhe trajnimeve për EbA, mbetet një çështje problematike për familjet dhe palët e interesuara në nivel lokal. Prandaj, zbatimi i fushatave ndërgjegjësuere dhe trajnimeve për publikun mbetet një instrument kyç për përmirësimin e këtyre çështjeve. Kapitulli i fundit i raportit paraqet një përmbledhje të konkluzioneve dhe konstatimeve të projektit si dhe rekomandimet për të pasur një zbatim më të mirë projektit. Replikimi (diskutimi analitik) i këtij studimi mbetet thelbësor për zbatimin e suksesshëm të projektit përsa i përket ndryshimeve të mundshme në elementet natyrore / sociale të zonës, përgjegjësitë administrative, etj. Raporti përfundimtar, i ka marrë në konsideratë të gjitha komentet dhe sugjerimet e bëra nga ekspertët e UNEP-it, koordinatori i projektit dhe përfaqësuesit e MM.

2 Parathënie

Shqipëria ndodhet në Gadishullin e Ballkanit Perëndimor, në Europën Juglindore dhe kufizohet nga Republika e Malit të Zi në veri, Republika e Kosovës në lindje dhe veri-lindje, Republika e Maqedonisë në lindje dhe nga Greqia në jug. Në perëndim, Shqipëria laget nga deti Adriatik dhe deti Jon. Deti Adriatik karakterizohet nga një vijë e ulët bregdetare, dhe përbëhet nga plazhe ranore dhe një sërë lagunash. Bregdeti i Kune Vain Tale është i vendosur në pjesën lindore të detit Adriatik dhe është shpallur Zonë e Mbrojtur - Rezervat Natyror i Menaxhuar, kategoria e IV, sipas IUCN.

Sistemi Lagunor Kune Vain Tale është i vendosur në tëdyja anët e grykëderdhjes të lumenjve Drin dhe Mat, në rajonin e Lezhës, në Shqipëri. Ky sistem lagunor ofron një gamë të gjërë të mirave dhe shërbimeve, shumë të vlefshme për komunitetin aty pranë. Rrita e shpejtë e popullsisë dhe përhapja e varfërisë në këtë zonë, kanë sjellë si pasojë dhe një rritje të presionit mbi lagunë për këto të mira dhe shërbime të ekosistemit, po ashtu edhe modifikime të paplanifikuara në zonën buferike, përreth lagunës. Komuniteti vendas e siguron pjesën më të madhe të ardhurave të tyre nga aktivitetet e peshkimit dhe bujqësisë dhe si pasojë ata varen drejtpërdrejt nga ekosistemet funksionale dhe të padëmtuara për të siguruar jetesën e tyre. Përdorimi i paqëndrueshëm i burimeve në SLKV, ka shkaktuar pakësim të cilësisë dhe sasisë të ujit të lagunës (me ndikim në prodhimtarinë e lagunës), gjithashtu edhe rritje të frekuencës të përmytjeve nga deti, si dhe rritje të erozionit të dunave ranore. Duke qënë i cënueshëm ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, Sistemi Lagunor Kune Vain pritet që të përjetojë përmytje më të shpeshta dhe më intensive, por edhe stuhi dallgësh të fuqishme. Ndryshimet klimatike kanë krijuar edhe probleme të tjera në të gjithë vendin. Ndër to mund të përmenden, si më poshtë:

- Rritja e intensitetit të erozionit në brigje/litorale dhe pyjet bregdetare, si dhe përmytja e tokave bujqësore. Si rezultat, janë reduktuar në mënyrë serioze vlerat turistike (reduktimi i plazheve); janë dëmtuar habitate të rëndësishme për florën dhe faunën (me vlera ekonomike dhe vizuale); prodhimi bujqësor po pëson një rënie të drejtpërdrejtë. Ekzistenca e lagunës është kërcënuar, si pasojë e shkatërrimit të litoraleve/brigjeve, por edhe si pasojë e krijimit në një trup të vetëm lagunë - uji i detit; migracioni është rritur (veçanarisht për të rinjtë që jetojnë në zonë) për shkak të humbjes të shpresës për ruajtjen e lagunës.
- Reduktimi i thellësisë të lagunës, si pasojë e sedimentimit intensiv që vjen nga zonat e eroduara dhe përmytjet, bllokimi i kanaleve të komunikimit midis detit dhe lagunës, etj. Ky fenomen ka shkaktuar efekte të drejtpërdrejta (ulje e prodhimit të peshqve në lagunë) dhe efekte jo të drejtpërdrejta (laguna më të prirura drejt eutrofikimit, si pasojë e zvogëlimit të mundësisë të qarkullimit të ujit në mënyrë vertikale dhe horizontale). Përveç këtyre efekteve, ndër të tjera mund të përmenden: reduktimi i sasisë të peshqve, reduktimi i numrit të turistëve, si dhe rënie e besimit të komunitetit në lidhje me vlerat e Zonës të Mbrojtur.
- Ndotja e vendeve të pastra është nxitur si pasojë e transportimit të ndotjes përmes vërshimit të rrymave të ujit nga kanali i shkarkimit të stacionit të pompimit të Tales në lagunën Ceka (zona e Vainit). Gjithashtu, ato po shkaktojnë degradim të mjedisit (në aspektin e reduktimit të cilësisë të mjedisit dhe potencialeve turistike) të zonës.

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

Për të adresuar këto probleme, Fondi i Veçantë për Ndryshimin e Klimës ka për qëllim të rritë kapacitetet e qeverisë dhe të komuniteteve lokale që jetojnë pranë SLKV për tu përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike duke përdorur një komplet të integruar të ndërhyrjeve të përshtatjes, duke përfshirë EbA. Ndërhyrjet e EbA do të rezultojnë në përfitime të shumta për komunitetin lokal, ekonominë dhe mjedisin, duke përfshirë: reduktimin e përmytjeve, përmirësimin e biodiversitetit dhe përmirësimin e produkteve të peshkimit.

Ndërhyrjet e përshtatjes dhe EbA do të përmirësojnë kapacitetet e komunitetit vendas për tu përshtatur ndaj ndikimeve negative të ndryshimeve klimatike.

Ky raport do të shërbejë si një rezultat ose bazë të dhënash shumë të rëndësishme për punimet që do të kryhen në të ardhmen në kuadër të projektit “Ndërtimi për rikuperimin e Lagunës së Kune-Vainit nëpërmjet përshtatjes me bazë ekosistemi. Ky projekt është përgatitur duke marrë parasysh kërkesat mjedisore dhe duke plotësuar sipas mundësive edhe kërkesat për turizmin, peshkimin apo aktivitete të tjera, por mbi të gjitha duke shmangur konfliktet me komunitetin dhe duke rritur, aq sa është e mundur interesin e tyre për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

3 Përshkrimi i projektit

Zona e Mbrojtur Kune Vain është Zona e parë e Mbrojtur në Shqipëri, e shpallur si zonë gjuetie nga viti 1940. Përgjatë këtyre viteve, kjo zonë u përdor për qëllime gjuetie dhe rekreative, deri në periudhën e Ekonomisë të Centralizuar, kur u deklarua si Rezervë Gjuetie. Si pasojë e ndërhyrjeve të paplanifikuara që ndodhën mbas viteve 1990, si dhe ekzistencës të zonave përreth me vlera të larta të biodiversiteti dhe rekreacioni, në vitin 2010 zona e lagunës të Kënallës u përjashtua nga Zonat e Mbrojtura, ndërsa bregdeti i Tales dhe lagunat përreth u përfshinë në rrjetin e Zonave të Mbrojtura. Në figurën më poshtë janë paraqitur foto të llojeve të rëndësishme të shpendëve në zonën e Vainit.




Figura 1 Shpendë të rëndësishëm në zonën e Vainit



Figura 2 Zona e ushqimit të Çafkës në pjesën e Vainit

Zona e Mbrojtur është shpallur Rezervë Natyrore e Menaxhuar (e kategorisë IV, sipas IUCN), ku zonimi përbëhet nga zona e mbrojtur strikte, zona e trashëgimisë dhe zona e përdorimit të qëndrueshëm, po ashtu edhe zona buferike. Zona e Mbrojtur përbëhet nga:

- Zona e Kunes– Ishulli i Kunes, litorali i Merxhanit dhe laguna e Merxhanit.
- Zona e Vainit – Laguna Zaje dhe Ceka, kënetat e Buallit, etj
- Zona e Tales – Bregdeti i Tales dhe laguna e Tales

Modifikimi i kombinuar me përdorimin e paqëndrueshëm të SLKV do të përkeqësohet edhe më tej nga efektet e ndryshimeve klimatike, në mënyra nga më të ndryshmet. Modelet aktuale të ndryshimeve klimatike parashikojnë një rritje të temperaturës të sipërfaqes të detit dhe temperaturës të ajrit (1.8°C deri në 2050), të cilat do të sjellin rritje të avullimit. Për më tepër, modelet globale të klimës gjithashtu parashikojnë reduktim të sasisë të rreshjeve, e cila do të rezultojë në rritje të kripësisë të lagunës, me pasoja të dëmshme mbi peshqit. Modelet parashikojnë një normë të përshtatjes të rritjes të nivelit të detit (deri në 61 centimetra deri në vitin 2100) që do të rezultojë, në rritje të erozionit dhe humbje të vazhdueshme të habitatit në SLKV. Së fundi, SLKV pritet të përjetojë përmbajtje më të shpeshta dhe më të fuqishme dhe stuhi të fuqishme detare. Të tilla ngjarje ekstreme do të shkaktojnë erozion të plazheve dhe pyjeve bregdetare, si dhe ndryshim të modeleve të rrjedhjes të ujit në SLKV, të cilat nga ana tjetër do të reduktojnë barrierat fizike ndaj ngjarjeve ekstreme nga përmbajtjet e detit dhe do të zvogëlojnë kapacitetet e lagunës për të mbrojtur komunitetin përreth, ndaj ngjarjeve të tilla. Në përgjithësi, efektet e ndryshimeve klimatike po reduktojnë kapacitetet e këtij sistemi, për të siguruar të mirat dhe shërbimet e ekosistemit për komunitetin vendas.

3.1 Fondi i Veçantë për Ndryshimin e Klimës dhe EbA

Për të adresuar të gjitha këto probleme të shkaktuara nga ndryshimet klimatike, projekti i Fondit të Veçantë për Ndryshimin e Klimës (SCCF) ka për qëllim të rrisë kapacitetet e qeverisë dhe komunitetit lokal që jeton pranë SLKV, të përshtatet ndaj ndryshimeve klimatike duke përdorur një komplet të integruar ndërhyrjesh të përshtatjes, përfshirë EbA, e cila konsiderohet të jetë me kosto më efektive, në terma afatgjatë, kundrejt masave të rënda të infrastrukturës. Përveç kësaj EbA është e njohur për gjenerimin e përfitimeve të përbashkëta si për ekonominë dhe shoqërinë, por edhe për të qënë më e qëndrueshme.

Objektivi kryesor i projektit është:

Të rritet kapaciteti i qeverisë dhe komuniteteve lokal që jetojnë pranë SLKV, për tu përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike, duke përdorur një komplet të integruar të ndërhyrjeve të përshtatjes, përfshirë EbA.

Ky objektivi do të arrihet përmes tre komponentëve plotësues:

- Përmirësimi i kapaciteteve teknike dhe institucionale të politikave dhe vendim-marrësve në Shqipëri, për të adresuar rreziqet nga ndryshimet klimatike përmes zbatimit të ndërhyrjeve të përshtatjes, përfshirë përshtatjen me bazë ekosistemi (EbA);
- Demonstrimi i ndërhyrjeve të përshtatjes në SLKV;
- Përmirësimi i ndërgjegjësimit dhe njohurive të komunitetit vendas dhe palëve të interesuara, në nivel kombëtar mbi efektshmërinë e EbA.

Kërkimi shkencor është përdorur për të zhvilluar një komplet të integruar të ndërhyrjeve të përshtatjes, duke përfshirë EbA, në mënyrë që të:

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

- Përmirësohet sasia dhe cilësia e ujit të lagunës, që do të rezultojë në përmirësimin e prodhimtarisë të lagunës;
- Reduktohet erozioni i dunave të plazheve, duke përmirësuar në këtë mënyrë qëndrueshmërinë e komunitetit ndaj përmbytjeve të bregdetit.

Ndërhyrjet e EbA-s do të sjellin përfitime të shumta për komunitetin lokal, ekonominë dhe mjedisin, duke përfshirë: i) reduktimin e përmbytjeve; ii) përmirësimin e biodiversitetit dhe iii) përmirësimin e prodhimtarisë të peshqve. Ky komplet i integruar ndërhyrjesh do të përmirësojë kapacitetin e ekosistemit për tu përshtatur ndaj ndryshimeve të klimës dhe do të sigurojë të mira dhe shërbime për komunitetin lokal. Prandaj, ndërhyrjet e përshtatjes dhe EbA do të përmirësojnë kapacitetet e komunitetit vendas për tu përshtatur ndaj ndikimeve negative të ndryshimeve klimatike.

Për më tepër, qëndrueshmëria e projektit do të sigurohet nga:

- i) forcimi i Grupit Ndër-Ministror të Punës për ndryshimet klimatike;
- ii) zhvillimi i një strategjie përshkallëzimi, e cila do të përfshijë trajnimin e vendim-marrësve në nivel lokal dhe kombëtar, mbi mënyrën se si të identifikojnë dhe sigurojnë fonde për projektet e EbA-s;
- iii) trajnimi i qeverisë kombëtare dhe komunitetit lokal për EbA-ën; dhe
- iv) zhvillimi dhe zbatimi i planeve të monitorimit

Projekti do të ndërtohet mbi bazën e projekteve të ndryshme, në vazhdim, ku përfshihen; Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes, projekti ECOSEA dhe Programi i UNEP për përshtatjen me bazë ekosistemi të bregdetit. Ky projekt do të ekzekutohet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), në Shqipëri dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP). Ndërhyrjet nëpërmjet EbA do të zbatohen në tre habitatet e ndërlidhura me SLKV, të cilat janë identifikuar si më tepër vulnerabël ndaj ndryshimeve të klimës. Këto habitate përfshijnë; lagunën Ceka, plazhet e degraduar pranë lagunës të Cekës dhe pyjet e degraduar në brendësi të SLKV.

3.2 Rëndësia Globale

Me anë të projektimit, zbatimit dhe monitorimit të duhur të ndërhyrjeve me bazë ekosistemi (EbA), projekti i financuar nga Fondi i Veçantë për Ndryshimet Klimatike (SCCF) do të kontribuojë gjithashtu në konservimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit, duke përfshirë edhe speciet me rëndësi globale. SLKV është Zona e parë e Mbrojtur në Shqipëri, e klasifikuar si Zonë e Mbrojtur e kategorisë së IV-t, sipas IUCN. Laguna gjendet në një zonë të njohur ndërkombëtarisht, si Zonë e Rëndësishme Zogjsh (IBA), e cila përbën një bazë dimërore për më shumë se 70 specie të shpendëve të ujit. SLKV përfshin habitate të rëndësishëm folenizues për shpendët, në veçanti për Pelikanin Kaçurrel (*Pelecanus crispus*), të kërcënuar globalisht dhe Karabullaku i vogël (*Phalacrocorax pygmeus*), si edhe lloje të shumta peshqish. Ky sistem lagunor përfshin mbi 270 lloje bimore, nga të cilat 18 janë të rrezikuara. Projekti ofron përfitime mjedisore, të një rëndësie globale nëpërmjet reduktimit të vulnerabilitetit të kësaj zone të rëndësishme nga pikëpamja ekologjike, por edhe për speciet që ndodhen aty dhe rrezikohen nga ndryshimet e klimës.

3.3 Komponentët e Projektit

Objektivi i projektit bazohet në tre outcome (rezultate) kryesore:

1. Kapacitetet teknike dhe institucionale për të adresuar rreziqet klimatike nëpërmjet EbA

Outcome 1; do të mbështesë politikat mjedisore që promovojnë EbA në Shqipëri, duke rritur kapacitetet teknike dhe institucionale të qeverisë kombëtare dhe lokale për të adresuar rreziqet e ndryshimeve klimatike bazuar në EbA.

2. Qëndrueshmëria ndaj rreziqeve të ndryshimeve klimatike përmes demonstrimit të praktikave më të mira në terren dhe zbatimit të EbA dhe ndërhyrjeve të tjera përshtatëse në Sistemin Lagunor Kune Vain

Outcome 2; do të demonstrojë praktikën më të mira në terren të EbA dhe ndërhyrjeve të tjera të përshtatjes në SLKV të degraduar. Të tilla ndërhyrje fokusohen në:

- Mbrojtjen e bregdetit dhe stabilizimin e dunave duke përdorur lloje bimore autoktone (pemë, shkurre, barishte), në mënyrë që të kontrollohet aktiviteti i erozionit dhe stabilizimi i pseudo-dunave. Bimët e përcaktuara për tu mbjellë, do të shërbejnë për të përmirësuar habitatet e degraduara të zonës dhe të reduktojnë në të ardhmen ndikimet negative të stuhive që vijnë nga deti, në zonën përreth.
- Përmirësimin e këmbimit të ujit të detit dhe lagunës të Cekës, në zonën e Vainit në mënyrë që të reduktohet rreziku nga eutrofikimi, të përmirësohet cilësia e ujit në lagunë dhe të rritet popullata e peshqve dhe specieve që jetojnë, folezohen dhe ushqehen në trupin e lagunës. Peshkimi mbetet një nga aktivitetet kryesore ekonomike dhe rekreative, në nivel lokal dhe kombëtar.

3. Ndërgjegjësimi dhe njohuritë mbi efekshmërinë e EbA

Outcome 3; do të rritë ndërgjegjësimin për avantazhet e EbA në nivel lokal dhe kombëtar, në mënyrë që të rritet aftësia për përshtatje ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
 – Vëzhgimi
 Bazë




Figura 3 Harta e territorit të parcelave të zgjedhura për ripëllëzim, e lidhur me statusin e mbrojtjes (zonimin) e Zonës të Mbrojtur Kune Vain, sikurse është zhvilluar në hartën bashkëngjitur VKM 432,2010 " Për aprovimin e Planit të Menaxhimit të Kune Vain Tale "

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë



Figura 4 Pamje e zonës që do të mbillet me *Ammophila arenaria* (barishte bregdetare) dhe *Tamarix sp.* (shkurre rezistente ndaj kripës dhe ujit).



Figura 5 Foto satelitore e kanalit që do të rihapet.

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

Të tilla ndërhyrje, duke pasur parasysh efektshmërinë e masave mbrojtëse do të ndihmojnë në përmirësimin e statusit socio-ekonomik të komunitetit, duke reduktuar efektet negative të shkaktuara nga ndryshimet klimatike dhe duke përmirësuar potencialet dhe kapacitetet për zhvillimin e peshkimit dhe turizmit natyror.

Projekti i Vëzhgimit Bazë u përgatit duke respektuar udhëzimet e ToR, detyrat, si dhe rezultatet e pritshme, për të përshtatur në mënyrën më të mirë të mundshme dokumentin bazë për rikuperimin e Lagunës së Kune Vainit nëpërmjet menaxhimit të efekteve ekzistuese dhe atyre të pritshme, të ndryshimeve klimatike. Projekti ka për qëllim të vlerësojë Indeksin e Vulnerabilitetit në lidhje me efektet e Ndryshimeve Klimatike dhe të vlerësojë Indikatorët dhe targetet, për secilin outcome të projektit.

4 Vlerësimi i Vëzhgimit Bazë

Gjatë fazës fillestare të projektit, për të vlerësuar zhvillimin e projektit dhe arritjen e rezultateve u zhvilluan një sërë indikatorësh, targetesh dhe vlerash bazë të orientuara me mënyrat e verifikimit. Në këtë kapitull janë përcaktuar dhe vlerësuar indikatorët dhe targetet origjinalë të përfshira në Kornizën e Rezultateve.

Të dhëna bazë për përcaktimin e indikatorëve të projektit u përzgjedhën në një mënyrë rigorozë shkencore. Të dhëna e grumbulluara u analizuan dhe u pasqyruan në mënyrë shkencore për të ofruar një dokument të besueshëm, të dobishëm për zhvillimet e projekteve në të ardhmen dhe rastet studimore të përshtatshme për projekte të ngjashme.

Informacioni bazë u grumbullua përmes:

- Rishikimit të të gjitha dokumenteve ekzistuese në lidhje me projektin
- Komunikimit të vazhdueshëm me Drejtuesit e Projektit
- Intervistave më familjet e përzgjedhura të komunitetit, në tre fshatrat përreth Zonës të Mbrojtur, në qytetet e Tiranës dhe Lezhës, si dhe intervistat me palët e interesuara që zotëronin aktivitet në Zonën e Mbrojtur Kune Vain
- Intervista me palët e interesuara lokale/rajonale dhe kombëtare, duke përfshirë zyrat qeveritare, institucionet kërkimore/shkencore, OJF-të, etj.
- Vizitat në terren dhe verifikimet.

4.1 Përshkrimi i Vëzhgimit

Vëzhgimi socio-ekonomik i kryer në tre fshatrat, e lidhur me Zonën e Mbrojtur KVT u zhvillua nga periudha 15 Prill deri në 16 Maj, të vitit 2017. Ky vëzhgim u krye me qëllim për të vlerësuar se sa vulnerabël ishte komuniteti vendas ndaj ndryshimeve klimatike, për të përcaktuar targetet dhe indikatorët, si dhe për të vlerësuar Strategjinë e Monitorimit të indikatorëve të projektit. Vëzhgimi kishte për qëllim të përcaktonte indikatorët dhe targetet për: 1) Outcome 2 *'Reduktimi i vulnerabilitetit për komunitetin që jeton pranë lagunës së Kune Vain-it përkundrejt ngjarjeve ekstreme të shkaktuara nga ndryshimet klimatike, nëpërmjet ndërhyrjeve pilot të përshtatjes, përfshirë EbA'* dhe 2) Outcome 3 *'Rritja e ndërgjegjësimit të palëve të interesuara lokale dhe kombëtare ndaj rreziqeve të ndryshimeve klimatike, si dhe potencialit të EbA për të rritur aftësinë e komunitetit vendas për tu përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike'*.

Vëzhgimi u fokusua në:

- Verifikimin/kontrollimin nga vëzhgimet në terren, të efekteve në natyrë të ndryshimeve klimatike në mënyrë që të vlerësohej 'ekspozimi'. Ndër të tjera u vlerësuan; ndryshimet e habitateve natyrore dhe humbja e vegjetacionit, erozioni i tokave (bregdetare), jeta e egër, dhe avifauna. Të njëjtat tipare mjedisore të 9-10 viteve më parë(2008) shërbyen si informacion bazë për krahasimin me situatën aktuale.
- Punë në zyrë u kryen për të krahasuar ndryshimet e gjëndjes të lagunës KV gjatë periudhës 1997-2008-2017, në të njëjtat stinë. Gjithashtu, u vlerësua dhe gjëndja socio-ekonomike e rajonit të Lezhës, gjatë 20 viteve të fundit.
- Një burim i rëndësishëm informacioni për vlerësimin e vlerave bazë, ishin intervistat dhe bisedimet me stafin e Zonës të Mbrojtur Kune Vain, ekspertët e rinj të të njëjtit staf, ekspertët e mjedisit dhe OJF-të, peshkatarët dhe anëtarët e komunitetit.
- U formuluan 2 (dy) lloje pyetësorësh, për të mbledhur informacion për familjet dhe për palët e interesuara në zonën e Kune Vain-it, si bazë për të vlerësuar 'ndjeshmërinë' dhe 'kapacitetin për tu përshtatur'. Një pyetësor, për të vlerësuar në mënyrë të përgjithshme, ndërgjegjësimin

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

ndaj ndryshimeve klimatike, për personat e intervistuar në qytetin e Lezhës dhe Tiranës, të mirënjohur si ‘turistë’ dhe nxënësit e shkollës në rajonin e Lezhës.

- U zhvilluan një sërë pyetjesh lidhur me indikatorët dhe targetet e projektit, të orientuara për institucionet dhe autoritetet qeveritare, në nivele lokal dhe kombëtar. Mbi bazën e tyre u organizuan bisedime dhe intervista, me përfaqësues të institucioneve target, kombëtare dhe lokale. Këto targete janë specifikuar edhe në Kornizën e Rezultateve të projektit. Shumica e pyetjeve kontribuan edhe për vlerësimin e vulnerabilitetit.

Për të lehtësuar mbledhjen e informacionit bazë, pyetësi për komunitetin ishte strukturuar si më poshtë:

- Të dhëna të përgjithshme: data e intervistës, emri i të intervistuarit, numëri i kontaktit, adresa e vendbanimit.
- Seksioni A) Të dhëna të përgjithshme mbi statusin ekonomik duke përfshirë; gjininë, pozicionin në familje, aksesin ndaj infrastrukturës ekzistuese dhe aksesin e ujit, etj.
- Seksioni B) Të dhëna për bujqësinë dhe aktivitetet blegtorale, mënyrën se për çfarë përdoren produktet bujqësore dhe blegtorale, produktet e peshkimit, të ardhurat nga këto aktivitete apo nga aktivitete të tjera nëse ekzistojnë.
- Seksioni C) Njohuritë rreth ndryshimeve klimatike
- Seksioni D) Problemet e lidhura me ndryshimet klimatike dhe përshtatja
- Seksioni E) Burimet Natyrore
- Seksioni F) Rreziqet Klimatike
- Seksioni G) Veçoritë e Projektit

Një strukturë e njëjtë pyetësi u hartua edhe për intervistat me palët e interesuara, i strukturuar si më poshtë:

- Të dhëna të përgjithshme rreth intervistës dhe emri i të intervistuarit, vendbanimi.
- Seksioni A) Të dhëna të përgjithshme mbi statusin ekonomik, përfshirë gjininë, pozicionin në familje, aksesin ndaj infrastrukturës ekzistuese, aksesin ndaj ujit, aseteve, etj.
- Seksioni B) Profili i biznesit, aksesin për infrastrukturën, përdorimi i burimeve natyrore, numri i të punësuarve, etj.
- Seksioni C) Njohuritë rreth ndryshimeve klimatike
- Seksioni D) Problemet e lidhura me ndryshimet klimatike dhe përshtatja
- Seksioni E) Burimet Natyrore
- Seksioni F) Rreziqet Klimatike
- Seksioni G) Veçoritë e Projektit

Përbërja e të dy pyetësorëve ndihmoi për të siguruar mbledhjen e informacionit të duhur, që së bashku me informacionin nga vendim-marrësit, vlerësimin nga vëzhgimet në terren dhe punën në zyrë (të dhënat shkencore) u përdorën për vlerësimin e vulnerabilitetit (referohuni Aneksit 8 dhe 10 për modelin e pyetësorit). Pyetësorët e hartuar për të mbledhur informacion në nivel njësie familjare dhe për palët e interesuara, në zonën e Kune Vainit, u përdorën gjithashtu si bazë për përcaktimin e ndjeshmërisë dhe kapacitetit të përshtatjes.

Në total, u kryen 128 intervista me familjet, 69 prej të cilave në fshatrat rreth Zonës të Mbrojtur, 29 intervista në qytetin e Lezhës dhe 30 intervista me familje në qytetin e Tiranës.

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë


	Tirane	Lezhe	Fshati Ishull- Shëngjini	Fshati Ishull- Lezhë	Fshati Barbullojë	Palët e interesuara në KV
Numri i pyetësorëve të plotësuar	30	29	25	28	16	24
Përqindja e femrave të intervistuar	63%	86%	32%	35%	0%	8.3%

Tabla 1 Shpërndarja gjeografike/territoriale e pyetësorëve

Në zonat urbane (qytetet e Tiranës dhe Lezhës), përqindja e femrave të intervistuar ishte e lartë. Për shkak të mentalitetit të zonës, në fshatrat e Ishull-Lezhës, Ishull-Shëngjinit dhe Barbullojës intervistimi i femrave ishte i vështirë dhe ndonjëherë, pothuajse i pamundur. Në fshatin Barbullojë ishte totalisht e pamundur të intervistoheshin femra.

Familjet e intervistuar u përzgjedhën në raport midis familjeve që kishin të ardhura të pakta, të mesme dhe të larta. Gjithashtu, intervistimit ju nënshtruan edhe të gjithë palët e interesuara që operonin në Zonën e Mbrojtur Kune Vain dhe kryesisht merreshin me aktivitetet e turizmit dhe peshkimit, duke përdorur pyetësorët për palët e interesuara. Në disa raste, i intervistuari ishte punonjës i subjektit, autorizuar nga aministratori i subjektit, (shiko Aneksin 5, 6 dhe 7 për familjet dhe palët e interesuara, të intervistuar).


Familjet dhe palët e interesuara të intervistuar u përcaktuan në bazë të fazës së para-përzgjedhjes, duke mbledhur informacion në terren dhe në zyrat e qeverisjes vendore për njerëzit që jetojnë rreth zonës dhe që me shumë mundësi ishin vulnerabël ndaj problemeve të shkaktuara nga ndryshimet klimatike, po ashtu u kryen edhe intervista rastësore për të vlerësuar njohuritë rreth ndryshimeve klimatike dhe EbA. Përqindje më të lartë të grupin moshor të intervistuar e përbënin ata me moshë më të madhe se 55 vjeç, sikurse tregohet dhe në grafikun 1. Ky grup kishte më shumë përvojë përsa i përket problemeve të shkaktuara nga ndryshimet e klimës dhe zakonisht ishte përgjegjës për familjen (kryefamiljar).



Grafiku 1 Përqindja e të intervistuarve sipas grup-moshës.


Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpëmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
 – Vëzhgimi
 Bazë

Grafiku i mëposhtëm tregon se për grupin e të intervistuarve me nivel arsimor të ulët dhe mesëm, shumica e të intervistuarve ishin meshkuj, kurse për grupin e të intervistuarve, që vazhdonin apo kishin përfunduar studimet e larta shumica e të intervistuarve ishin femra.



Grafiku 2 Niveli i arsimit sipas gjinisë.


21.7 % e të intervistuarve ishin të punësuar dhe shumica e tyre merreshin me aktivitete bujqësore dhe blegtorale si profesion dytësor. Sektori i punësimit të meshkujve dominohej kryesisht nga aktivitetet bujqësore dhe blegtorare, por edhe aktivitetet e peshkimit.



Grafiku 3 Statusi i punësimit, sipas gjinisë (komuniteti, fshatrat).

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

Grafiku nr. 3 më poshtë, tregon qartë se shumica e familjeve të intervistuar merreshin me aktivitetin e bujqësisë, produktet e të cilit përdoren kryesisht për vetë konsum. Prandaj, mënyra e jetesës së tyre mbështetet nga aktivitetet e fermës. Vetëm një pjesë e vogël e familjeve tregëtonin dhe merrnin përfitime nga produktet bujqësore të mbjella, për tu tregëtuar (kryesisht lloje të ndryshme perimesh, pemë frutore, ullinj, portokall, mandarina). Arsyet për të cilën vetëm një pjesë e vogël e familjeve mbillnin produkte për të tregëtuar janë listuar më poshtë: zona bujqësore jo shumë produktive, karakteristika jo të përshtatshme të tokës, humbjet që shkaktohen nga përmytjet dhe thatësira gjatë periudhës të verës.



Grafiku 4 Përdorimi i kulturave bujqësore.

Shumica e familjeve zotëronin bagëti, kryesisht lopë, derra dhe pula. Personat që merreshin me aktivitetin e peshkimit deklaruan se ata i përdornin produktet e peshkut për vetë-konsum. Për shumicën e të intervistuarëve, mjettet e tyre e jetesës ishte e prekur drejtpërdrejt nga ndryshimet e klimës. Të tilla mjete jetese përfshinin; bujqësinë, punën e rastit kundrejt pagesës, mbarështimin e bagëtisë, peshkimin, tregëtinë dhe turizmin.

Statistika të tjera deskriptive të familjeve të intervistuar (në tre fshatrat), të tilla si: statusi i punësimit, burimet e jetesës, burimi kryesor i ujit, etj, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.


Statusi i punësimit të të intervistuarve	Përqindja e të intervistuarve(Totale)	Përqindja e të intervistuarve sipas gjinisë	
		Meshkuj (%)	Femra(%)
Profesioni kryesor (%)			
I punësuar me pagesë	21.7 %	15.9 %	5.8 %
I vetë-punësuar(biznes)	15.9 %	13 %	2.9%
Punë në fermë	20.3 %	20.3 %	0
Punë e rastit kundrejt pagesës	11.6%	11.6 %	0
I papunë	24.7 %	13.1 %	11.6 %
Tjetër, student, në pension, etj	5.8%	0 %	5.8 %
Burimi kryesor i ujit në familje			
Lloji i burimit të ujit	Përqindja (%)		
Çezma publike	58 %		
Ujë pusi	42%		

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

Burimi kryesor i ujit për ujitje	Uji i shiut dhe kanalet e vaditjes 56.9 %
	Burime të tjera (ujë pusi etj.) 43.1%
Pronësia e tokës bujqësore, përdorimi i tokës dhe i produkteve bujqësore në përqindje (%)	
Familje që kanë në pronësi tokë bujqësore	94.2 %
Përdorimi i kulturave bujqësore	100 %
Tregëtimi i kulturave bujqësore	7.2 %
Përdoimi i kulturave bujqësore për konsum vetjak	92.8 %
Përqindja e të intervistuarve që merreshin me aktivitetin e blegtorisë dhe peshkimit (%)	
Familje që kanë bagëti në pronësi	76.8 %
Familje që merren me aktivitetin e peshkimit	23.2 %

Tabela 2 Statistika deskriptive mbi statusin e punësimit, mjetet e jetesës, burimin kryesor të ujit, etj.

Grafiku 5, tregon perceptimin lidhur me njohuritë rreth ndryshimeve klimatike dhe EbA, sipas gjinisë. Në grafik tregohet se femrat kanë njohuri të plotë rreth konceptit të ndryshimeve klimatike më shumë se sa meshkujt. Ky rezultat, shpjegohet me faktin e kualifikimit arsimor të përmendur më sipër (shumica e femrave kishin nivel arsimor më të lartë se meshkujt/diplomë universitare).




Grafiku 5 Mënyra e perceptimit rreth njohurive për ndryshimet klimatike, sipas gjinisë

Në grafikun e mëposhtëm, nr.6, janë paraqitur efektet e ndryshimeve klimatike lidhur me sasinë e rreshjeve, temperaturën, përmblytjet dhe thatësinë, të vërejtura nga personat e intervistuar në 5 vitet e fundit. Sikurse paraqitet dhe në grafik, shumica e të intervistuarve kishin vënë re një rënie në sasinë vjetore të rreshjeve, asnjë ndryshim në sezonin e shirave, rritje të temperaturës dhe thatësisë dhe më shumë ngjarje të përmblytjeve.

Më shumë të dhëna të detajuara mbi familjet dhe palët e interesuara (në lidhje me statusin socio-ekonomik,etj) janë paraqitur në anekset bashkëngjitur këtij dokumenti.

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
 – Vëzhgimi
 Bazë



Grafiku 6 Efektet e ndryshimeve klimatike në lidhje me modelin e rreshjeve, temperaturës, përmbajtjeve dhe thatësirës.

Targete të tjera të rëndësishme të këtij vëzhgimi ishin edhe institucionet që merren me çështjet e krijuara nga ndryshimet klimatike, Zonat e Mbrojtura, në lagunën e Kune Vainit.

Për më shumë detaje refrohuni Aneksëve 1, 2, 3, 4, 5, dhe 6.

Informacion u grumbullua nga të gjithë institucionet targetet që ishin marrë në konsideratë në Vëzhgime Bazë të mëparshme, por edhe institucione të tjera, të lidhur me Grupin Ndër-Ministror të Punës mbi Ndryshimet Klimatike. Informacioni u grumbullua me anë të pyetësorëve, në tre lloj mënyrash: takime

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

indiiduale, me anë të email-it dhe me skype ose telefonata. Nga intervistat me përfaqësuesit apo specialistët e këtyre institucioneve u përcaktua se institucioni përgjegjës kryesor në lidhje me efektet e ndryshimeve klimatike dhe EbA është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Ministria e Energjisë, Ministria e Planifikimit Urban dhe Sekretariati Qëndror i Ujrave kishin gjithashtu staf apo grup që koordinoheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë me institucionet e tjera dhe që merrnin pjesë në planifikime, etj. Anëtarët e stafit të këtyre institucioneve ishin të trajnuar në lidhje me ndryshimet klimatike, por jo për EbA. Institucione të tjera, po ashtu edhe ato të emëruara në Grupin Ndër-Ministror të Punës me Urdhër të Kryeministrit, kishin marrë pjesë në takime, mbledhje, etj, të lidhura me ndryshimet klimatike, por sërish kishin njohuri të pakta rreth EbA.

Institucionet rajonale/lokale në rajonin e Lezhës, kishin marrë pjesë shumë pak në takime dhe nuk ishin shumë mirë të fokusuar mbi EbA.

4.2 Studimi bazë – Vlerësimi i vulnerabilitetit

Koncepti për analizimin e vulnerabilitetit u bazua në përkufizimin e Ndryshimeve Klimatike për Vulnerabilitetin të Panelit Ndër-qeveritar: *“shkalla në të cilën një sistem është i ndryshëm ose i paaftë për tu përballur me efektet negative të ndryshimeve klimatike, duke përfshirë ndryshueshmërinë e klimës dhe ngjarjet ekstreme të saj. Vulnerabiliteti është funksion i vetisë, madhësisë dhe shkallës të ndryshimit të klimës, ndaj të cilit një sistem është i ekspozuar, është i ndryshëm dhe ka kapacitete për tu përshtatur”*. Të kuptuarit e vulnerabilitetit kërkon një trajtim të integruar që merr në konsideratë së bashku, si rreziqet fizike (efektet sipërfaqësore të klimës), po ashtu edhe dimensionet sociale (ndryshueshmërinë/aftësinë për tu përshtatur). Prandaj, vulnerabiliteti shprehet si shuma totale e tre komponentëve:

- **Ekspozimi** – lloji dhe shkalla ndaj të cilave një sistem është i ekspozuar ndaj ndryshimeve të rëndësishme të klimës
- **Ndjeshmëria** – reagimi i një sistemi ndaj ndryshimeve të klimës (në varësi të kushteve socio-ekonomike dhe mjedisore).
- **Kapaciteti për tu përshtatur** – aftësia e komunitetit për tu riorganizuar dhe minimizuar humbjet përballë efekteve të ndryshimeve klimatike. Për pjesën më të madhe, kjo varet nëse komuniteti ka të drejtë mbi pasuritë natyrore, financiare, sociale, humane dhe fizike.

4.2.1 Metodologjia e vlerësimit të vulnerabilitetit

Përcaktimi i Indikatorëve Përbërës të Vulnerabilitetit

Indeksi i vulnerabilitetit për komunitetin u zhvillua për të treguar nivelin në të cilin familjet dhe palët e interesuara, në zonën ku do të zbatohen ndërhyrjet nga projekti janë të prirura që të dëmtohen nga efektet e ndryshimeve të klimës. Bazuar në rishikimin e literaturës për vlerësimin e vulnerabilitetit ndaj ndryshimeve klimatike u përcaktuan indikatorët socio-ekonomik dhe mjedisor, në mënyrë që të pasqyroheshin tre komponentët e vulnerabilitetit: ekspozimi, ndjeshmëria dhe aftësia për tu përshtatur. Indeksi i vulnerabilitetit u zhvillua mbi bazën e të dhënave të mbledhura nga vëzhgimet në terren, intervistat me familjet dhe palët e interesuara, si dhe vlerësimi me anë të një metodologjie të qartë.

Gjithashtu për vlerësimin e Indeksit të Vulnerabilitetit u zhvillua edhe matrica e vulnerabilitetit të komunitetit me indikatorët përbërës, njësinë e matjes dhe rezultatet (pikët). Kjo matricë përbëhet nga 16 komponentë të indikatorëve, të klasifikuar si përbërës të Indeksit të Vulnerabilitetit, të tillë si; Ekspozimi, Ndjeshmëria dhe Përshtatja. Për vlerësimin e vulnerabilitetit u morrën në konsideratë gjithsej 2 pikë, ku ‘0’ pikë tregon indeksin më të ulët të vulnerabilitetit dhe ‘2’ pikë atë më të lartë.

Familjet dhe palët e interesuara u identifikuan në bazë të: fazës të para-përzgjedhjes të orientuar sipas termave të referencës dhe të dhënave ekzistuese të projektit; mbledhjes të informacionit në terren dhe në zyrat e qeverisjes vendore; komunitetin e zonës përreth, mundësisht vulnerabël ndaj problemeve të krijuara nga ndryshimet klimatike; dhe intervistat rastësore për të vlerësuar perceptimin rreth ndryshimeve klimatike dhe EbA.

Komponentë e indikatorëve të zgjedhur përfaqësojnë: i) kushtet fizike të zonës; ii) kushtet socio-ekonomike të familjeve dhe palëve të interesuara në zonën e Kune Vain-it dhe fshatrat përreth; iii) perceptimet për ndikimet e ndryshimeve klimatike në burimet natyrore dhe mënyrën e jetesës dhe trajnimet e mundshme.

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpëmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

Të gjitha këto më sipër do të kontribuojnë në vlerësimin e vulnerabilitetit ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, si pjesë e përshtatjes. Prodhimi total dhe përshtatja, bazë e EbA mbeten një pikë e rëndësishme për komponentët e indikatorit të përshtatjes.




Figura 1 Struktura e vulnerabilitetit – Komponentët dhe Indikatorët

- Ekspozimi do të shprehet si: \sum_6^1 indikatorëve
- Ndjeshmëria do të shprehet si: \sum_{13}^7 indikatorëve dhe
- Kapaciteti i përshtatjes do të shprehet si: \sum_{16}^{14} indikatorëve

Indeksi i Vulnerabilitetit është vlerësuar si produkt i ekspozimit dhe ndjeshmërisë duke zbritur vlerën e kapacitetit të përshtatjes.

$$\text{Vulnerabiliteti} = (\text{Ekspozimi} \times \text{Ndjeshmëria}) - \text{Kapaciteti i Përshtatjes}$$

Sikurse u përmend edhe në kapitullin “Përshkrimi i Metodologjisë”, “Vlerësimi i Vulnerabilitetit” është llogaritur dhe ndarë në tre pjesë.

Ekspozimi – Rezultatet (të paraqitura me pikë) pasqyrojnë ekspozimin e zonës. Sipas të cilës, 0 (pikë)- pasqyron asnjë ndryshim, 1 (pikë)- ndryshime jo të konsiderueshme dhe 2 (pikë)- ndryshime të rëndësishme.

Ndjeshmëria – ka të njëjtën metodologji llogaritje. 0 (pikë)- kur nuk është vërejtur ndonjë lloj ndikimi, 1 (pikë)- me efekte mesatare të vërejtura dhe 2 (pikë)- tregon ndikimet e larta në zonë.

Kapaciteti i përshtatjes – ka një llogaritje të anasjelltë, të komponentëve të indikatorëve krahasuar me dy të mësipërmit. 0 (pikë) – paraqet nivele të ulta të njohurive, 1 (pikë) – nivele mesatare dhe 2 (pikë) – nivele të larta të të pasurit informacion. Më poshtë është dhënë tabela e Vlerësimit të Indeksit të Vulnerabilitetit, ku janë paraqitur indikatorët dhe pikët e tyre bazuar në intervistat me familjet. (Shiko Aneksin 4 për pikët e indikatorëve dhe komponentëve përbërës bazë për përcaktimin e Indeksit të Vulnerabilitetit për Zonën e Mbrojtur).

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpëmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

Indesi	Komponentët e Indikatorëve	Njësia e Matjes	Pikët		
			0	1	2
Ekspozimi	1) Ndryshim në sasinë e rreshjeve vjetore	Individual/Anëtar familje	Asnjë ndryshim i vërejtur në sasinë e rreshjeve	Ka pasur ndryshim të sasisë të rreshjeve, por nuk ka pasur ndonjë ndikim në familje/individ	Ka pasur ndryshim në sasinë e rreshjeve dhe ndikime negative në familje/individ
	2) Ndryshim në periudhën e sezonit të shirave	Individual/Anëtar familje	Asnjë ndryshim i vërejtur në periudhën e sezonit të shirave	Ka pasur ndryshim të periudhës të sezonit të shirave, por pa ndikim në familje/individ	Ka pasur ndryshim në periudhën e sezonit të shirave dhe ka sjellë ndikime negative në familje/individ
	3) Ndryshim në temperaturë	Individual/Anëtar familje	Asnjë ndryshim i vërejtur në temperaturë	Ka pasur ndryshim të temperaturës, por nuk ka pasur ndonjë ndikim në familje/individ	Ka pasur ndryshim të temperaturës dhe ka sjellë ndikime negative në familje/individ
	4) Ndryshim në frekuencën e episodeve të thatësirës	Individual/Anëtar familje	Asnjë ndryshim i vërejtur në frekuencën e episodeve të thatësirës	Ka pasur ndryshim në frekuencën e episodeve të thatësirës por kjo nuk ka sjellë ndonjë ndikim në familje/individ	Ka pasur ndryshim në frekuencën e episodeve të thatësirës dhe kjo ka sjellë ndikime negative në familje/individ
	5) Ndryshim në frekuencën e ngjarjeve të përmbytjeve	Individual/Anëtar familje	Asnjë ndryshim i vërejtur në frekuencën e ngjarjeve të përmbytjeve	Ka pasur ndryshim në frekuencën e ngjarjeve të përmbytjeve, por pa ndonjë ndikim në familje/individ	Ka pasur ndryshim të frekuencës të përmbytjeve dhe kjo ka sjellë ndikime negative në familje/individ
	6) Ndryshim në nivelin e insekt-dëmtuesve	Individual/Anëtar familje	Asnjë ndryshim i vërejtur në nivelin e insekt-dëmtuesve	Ka pasur ndryshim të nivelit të insekt-dëmtuesve, por nuk ka sjellë ndonjë ndikim në familje/individ	Ka pasur ndryshim të nivelit të insekt-dëmtuesve dhe kjo ka sjellë ndikime negative në familje/individ

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpëmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

Ndjeshmëria	7) Ndryshim në rendimentin e të kulturave bujqësore	Individual/Anëtar familje	Asnjë ndryshim i vërejtur në rendimentin e kulturave	Ka pasur ndryshim të rendimentit të kulturave por pa ndikim në familje/individ	Ka pasur ndryshim në rendimentin e kulturave dhe kjo ka sjellë ndikime negative në familje/individ
	8) Ndryshim në mjedisit natyror	Individual/Anëtar familje	Asnjë ndryshim i vërejtur në mjedisin natyror	Ka pasur ndryshim të mjedisit natyror por pa ndikime në familje/individ	Ka pasur ndryshim të mjedisin natyror dhe kjo ka sjellë ndikime negative në familje/individ
	9) Niveli i varësisë	Individual/Anëtar familje	Madhësia e familjes varion nga 1 deri në 3 anëtarë/familje	Madhësia e familjes varion nga 4 deri në 6 anëtarë/familje	Madhësia e familjes është më e madhe se 6 anëtarë/familje
	10) Mënyrat e ujitjes	Individual/Anëtar familje	Vaditje 100%	E përzier	Uji i shiut
	11) Burimet e jetesës	Individual/Anëtar familje	Familja ushtron aktivitet bujqësor, blegtoral, apo aktivitet peshkimi vetëm për të përfituar të ardhura mujore	Përdorimi i aktiviteteve bujqësore, blegtorale dhe peshkimit nga familja për të gjeneruar të ardhura mujore dhe për konsum vetjak	Familja ushtron aktivitete bujqësore, blegtorale dhe aktivitetet e peshkimit vetëm për konsum vetjak
	12) Ndryshim në cilësinë dhe sasinë e burimeve ujore	Individual/Anëtar familje	Asnjë ndryshim i vërejtur në sasinë dhe cilësinë e burimeve ujore	Pak ndryshim të vërejtura në sasinë dhe cilësinë e burimeve ujore, por pa ndikime në komunitet/familje	Ka pasur ndryshim të sasisë/cilësisë të burimeve ujore, e shoqëruar me ndikime negative në komunitet/familje

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

	13) Humbje e tokave, dherave, plazheve	Individual/Anëtar familje	Asnjë humbje në toka, dherave, plazheve	Pak humbje të tokave, dherave, plazheve, por pa ndikime në komunitet/familje	Ka pasur humbje të tokave, dherave, plazheve shoqëruar me ndikime negative për komunitetin/familjen
Kapaciteti për përshtatje	14) Njohuritë rreth ndryshimeve klimatike	Individual/Anëtar familje	Familjet/banorët e komunitetit nuk kanë njohuri rreth ndryshimeve klimatike	Një pjesë e vogël e familjeve/komunitetit dhe qytetarëve kanë njohuri rreth ndryshimeve klimatike	Shumica e familjeve/komunitetit dhe qytetarëve kanë njohuri rreth ndryshimeve klimatike
	15) Informacione/trajtime	Individual/Anëtar familje	Familjet/Komuniteti nuk janë të mirë informuar dhe trajnuar	Një pjesë e vogël e familjeve/komunitetit dhe qytetarëve janë të mirë informuar dhe trajnuar	Shumica e familjeve/komunitetit dhe qytetarëve janë të mirë informuar dhe trajnuar
	16) Praktikrat e bazuara në EbA nga familjet	Individual/Anëtar familje	Familjet/komuniteti nuk kanë aplikuar praktika të bazuara në EbA	Një pjesë e vogël e familjeve/komunitetit kanë aplikuar praktika të bazuara në EbA	Shumica e familjeve/komunitetit kanë aplikuar praktika të bazuara në EbA

Tabela 3 Indikatorët përbërës të Vlerësimit të Vulnerabilitetit, njësia e matjes dhe pikët

4.3 Rezultatet e Vlerësimit të Vulnerabilitetit

Komponentët e indikatorëve të vulnerabilitetit u zgjodhën dhe u vlerësuan në bazë të objektivave të projektit, karakteristikave të zonës dhe përdorimit të tokës (aktivitetet dhe përdoruesit).

Sikurse është përmendur edhe më sipër, për Vlerësimin e Vulnerabilitetit u morrën parasysh intervistat me palët e interesuara dhe komunitetin, informacioni ekzistues i disponueshëm për të dhënat e monitorimit teknike dhe shkencore, si dhe vëzhgimet në terren të bëra nga konsulenti. Në rastet kur familjet nuk ishin të sigurta në përgjigjet e tyre, informacioni shkencor dhe të dhëna nga autoritetet rajonale u kosideruan si shumë të rëndësishme për llogaritjen e vulnerabilitetit. Shembull: Ndryshimet e temperaturës ose ndryshimet në sasinë e rreshjeve, etj.

Vlerësimi i komponentëve të indikatorit të ekspozimit u bazua në të dhëna teknike, të përpunuara me të dhënat ekzistuese nga studime të mëparshme, gjithashtu informacioni i mbledhur u verifikua/kontrollua me rezultatet e intervistave të familjeve dhe palëve të interesuara.

Shumica e të dhënave teknike u siguruan nga raportet teknike ekzistuese, pjesa më e madhe e të cilëve te lidhura me EbA. Këto të dhëna i referoheshin indeksit të ekspozimit.

Mesatarja e indeksit të ekspozimit për familjet dhe palët e intresuara në tre fshatrat ishte 3.24. Për më shumë detaje lutemi referohuni anekseve përkatëse.

Llogarita e Indeksit të Ndërgjegjësimit për ndryshimet klimatike në Zonën e Mbrojtur Kune Vain Tale

Ndërgjegjësimi për ndryshimet klimatike = Ndërgjegjësimi konceptual + Ndërgjegjësimi eksperimental + Angazhimi

Më tej, për të normalizuar rezultatin në intervalin nga 0% në 100 %, pikët e ndërgjegjësimit për ndryshimet klimatike u pjestuan me pikët më të larta, të mundshme (X) dhe u shumëfishuan me koeficientin 100:

$$\text{Ndërgjegjësimi në (\%)} = \frac{\text{Pikët e ndërgjegjësimit për ndryshimet klimatike}}{9} \times 100 = \frac{3}{9} \times 100 =$$

Komponentët e indikatorit	Njësia e matjes	Pyetja ekzakte	Pikët			
			0	1	2	3
Ndërgjegjësimi konceptual	Individual	Çfarë janë ndryshimet klimatike ?	Nuk ka dëgjuar asnjëherë për ndryshimet klimatike	Ka dëgjuar për to, por ka njohuri të limituara	Kupton shkaqet, por nuk di efektet	I kupton shkaqet dhe efektet
Ndërgjegjësimi eksperimental	Individual	A i keni ndjerë efektet e ndryshimeve klimatike ?	Jo/Nuk është i sigurt	Ndoshta, jepni shembuj lidhur me ndryshimet e motit .	Po, jepni shembuj lidhur me tendencat afat gjata	Po, jepni shembuj të ndryshimeve afat-gjata dhe të ndikimeve në mjetet e jetesës.
Angazhimi	Individual	A flisni për ndryshimet	Kurrë	Rrallë (ndoshta një herë në muaj)	Shpesh (ndoshta njëherë në javë)	Shumë shpesh (më shumë se një herë në javë)

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

		klimatike?			
--	--	------------	--	--	--


Tabela 4 Index i Ndërgjegjësimit për Ndryshimet Klimatike – komponentët e Indikatorit, njësia e matjes, pyetja ekzakte dhe pikët

4.3.1 Rezultatet e Indeksit të Vulnerabilitetit për KVT

Më poshtë janë paraqitur treguesit e analizuar për ekspozimin, ndjeshmërinë, kapacitetin e përshtatjes dhe ndërgjegjësimin ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe treguesi bazë total i vulnerabilitetit. Pikët e detajuara për secilin nga të 16-të komponentët, si dhe përbërësit e indikatorit janë paraqitur në Aneksin përkatës (Aneksi 4).

Mesatarja e Indeksit të ekspozimit

Nga një maksimum i pikëve të indikatorit, prej 12 pikë fshati Ishull-Lezhë ka mesataren më të lartë të indeksit të ekspozimit prej 3.43, ndërsa fshati Ishull-Shëngjin ka mesataren më të ulët të indeksit të ekspozimit, përkatësisht 2.9. Mesatarja e indeksit të ekspozimit për familjet e intervistuar në tre fshatrat ishte 3.21.




Grafiku 4 Mesatarja e indeksit të ekspozimit

Mesatarja e indeksit të ndjeshmërisë

Nga një maksimum i pikëve të indikatorit prej 14, fshati Barbullojë kishte mesataren më të lartë të indeksit të ndjeshmërisë, përkatësisht 4.03, ndërsa vlerën më të ulët e kishte fshati Ishull-Shëngjin, me vlerë 3.8. Mesatarja e llogaritur për indeksin e ndjeshmërisë, për familjet e intervistuar në tre fshatrat përreth Zonës të Mbrojtur Kune Vain Tale ishte 3.89. Komuniteti në fshatin Barbullojë ishte më i ndjeshëm ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike në krahasim me komunitetin në dy fshatrat e tjerë, kjo për arsye të ndikimeve dyfish më të mëdha që vinin nga përmbytjet nga laguna dhe uji i detit, si dhe nga kanali kryesor i kullimit në Tale.


Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpëmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë



Grafiku 5 Mesatarja e indeksit të ndjeshmërisë

Mesatarja e indeksit të kapacitetit të përshtatjes

Mesatarja e indeksit të kapacitetit të përshtatjes për familjet e intervistuar në tre fshatrat ishte 0.39. Indeksi i kapacitetit për tu përshtatur ishte i ulët në të tre fshatrat dhe varionte nga 0.34 në Barbullojë, 0.36 në fshatin Ishull-Shëngjin dhe 0,48 në fshatin Ishull-Lezhë. Në bazë të rezultateve u arrit në përfundimin se komuniteti përreth Zonës të Mbrojtur ende nuk ka përvojë në zbatimin e masave të përshtatjes, për tu përballur me ndikimet e ndryshimeve klimatike.




Grafiku 6 Mesatarja e indeksit të kapacitetit të përshtatjes

Mesatarja e ndërgjegjësimit ndaj ndryshimeve klimatike

Në përgjithësi, mesatarja e ndërgjegjësimit ndaj ndryshimeve klimatike ishte e ulët në të tre zonat e ndërhyrjes nga projekti. Mesatarja e indeksit të ndërgjegjësimit ndaj ndryshimeve klimatike ishte 37 %, nga maksimumi i mundshëm prej 100%.


Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpëmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë



Grafiku 7. Ndërgjegjësimi ndaj ndryshimeve klimatike sipas fshatrave dhe mesatarja e ndërgjegjësimimit

Mesatarja e indeksit të vulnerabilitetit

Vlera e përgjithshme e vulnerabilitetit ishte në përgjithësi e lartë në të tre fshatrat ku u krye vëzhgimi. Mesatarja e vulnerabilitetit përreth zonës ku do të kryhen ndërhyrjet nga projekti ishte 12.09. Gjithashtu, fshati i Barbullojës rezultoi të ishte më shumë vulnerabël ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike, krahasuar me dy fshatrat e tjerë përreth Zonës të Mbrojtur.



Grafiku 8 Mesatarja e indeksit të Vulnerabilitetit

Vlerësimi i komponentëve të Indikatorëve të Ekspozimit dhe Ndjeshmërisë u realizua bazuar në informacionin e mbledhur nga autoritetet përkatëse Lokale/Rajonale/Kombëtare, po ashtu dhe nga intervistat me familjet.

Vlerësimi i komponentëve të Indikatorit të Kapacitetit të Përshtatjes u bazua në intervistat me familjet, si dhe përpunimi i informacionit nga vendim-marrësit dhe specialistët.

Gjithashtu, sikurse për familjet e njëjta metodologji u zbatua për të vlerësuar indeksin e vulnerabilitetit edhe për palët e interesuara. (Për më shumë detaje, referohuni Aneksit 3)

4.4 Studimi bazë – Metodologjia e vlerësimit

Metodologjia e punës u bazua në punët dhe detyrat e përcaktuara sipas ToR, po ashtu edhe të afateve kohore (4 muaj) dhe të lidhura me dokumentin e projektit ‘Rikuperimi i Kune Vain-it’

Metodologjia e punës u orientua mbi vlefshmërinë e targeteve dhe indikatorëve të përcaktuar, dhe efektshmëria e tyre aktuale u bazua në pikat e mëposhtme:

- Dhënie prioriteti indikatorëve të identifikuar dhe të kuptuarit e lidhjes midis indikatorëve. Vlerësim i qartë i targeteve të secilit indikator. Indikatorët kryesorë janë të lidhur me:
 - a) Indikatorët bio-fizik, të fokusuar në: erozionin e bregdetit, sedimentimin e kanaleve dhe trupit të lagunës, eutrofikimin (lulëzimin e algave), reduktimin e bimësisë dhe të florës/faunës të tokës, reduktimin e peshqve, plazheve, etj, gjithashtu të lidhura me ndikimet e ndryshimeve klimatike.
 - b) Indikatorët dhe targetet socio-ekonomik: Indikatorët bazë të komunitetit, nga pikëpamja sociale dhe ekonomike janë; aktivitetet kryesore të lidhur me sistemin lagunor, të ardhurat reale nga aktivitetet e turizmit dhe peshkimit, lidhja midis ndryshimeve socio-ekonomike me ndryshimet e indikatorëve bio-fizikë të shkaktuar nga ndryshimet e klimës, etj. Vlerësimi i targeteve për secilin indikator dhe përgatitja e një plani vrojtimi.
 - c) Indikatorët dhe targetet e institucioneve qeveritare: numri dhe cilësia e stafit të menaxhimit, palët e interesuara dhe varësia e ZM, marrdhëniet midis stafit të menaxhimit të lagunës, palëve të interesuara, vendim-marrësve dhe komunitetit, kërkesat dhe planet e palëve të interesuara, kuadri ligjor, marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe, kushtet e konventave ndërkombëtare dhe plani i menaxhimit të zonës, etj.

Punë në zyrë u krye me qëllim që të vlerësoheshin indikatorët kryesor, lidhur me tre pikat e përmendura më sipër. Vlerësimi u bë sipas hapave të mëposhtëm, duke u konsultuar më nga afër edhe me specialistë kombëtarë. U ndërmorrën një sërë vëzhgimesh në terren, me qëllim që të identifikoheshin rëndësia e indikatorëve të përcaktuar. Kërkime të tjera shtesë, ndihmuan konsulentin të kontaktojë dhe intervistojë vendim-marrësit kryesor të konsideruar si indikatorë ose targete. Këto aktivitete janë përshkruar edhe në paragrafin e mëposhtëm.

- Analizimi i burimeve të nevojshme për vlerësimin e indikatorëve, nëpërmjet vëzhgimeve në terren, punës në zyrë, intervista me organet administrative që merren kryesisht me EbA dhe konsultime me institucionet monitoruese dhe shkencore.
- Marrja në konsideratë se; nga kush do të mbledhen të dhënat, cili do të përpunojë dhe vlerësojë, përsa i përket rezultateve.
- Vlerësimi i targeteve, për secilin indikator të vlerësuar. Përgatitja e dy tipe pyetësorësh të thjeshtuar, për dy grupet kryesore të targeteve sociale; një për palët e interesuara; dhe një tjetër për komunitetin (fermerët, etj). Një tjetër pyetësor i thjeshtuar, u përdor për të marrë opinionet e një grupi të vogël banorësh të qytetit të Lezhës dhe Tiranës, në mënyrë që të vlerësohej niveli i ndërgjegjësimit për qytetarët. Të gjitha këto, nga sa më sipër u kryen në kuadër të “Kornizës Logjike” të dokumentit të projektit.
- Mbas mbledhjes të informacionit bazë, për të përcaktuar lidhjen midis indikatorëve u krye një klasifikim i tyre, dhe më pas u realizua përpunimi i të dhënave.
- Shpërdarja e rezultateve midis konsulentëve të tjerë të projekti, ekspertëve të UNEP dhe ekspertët e MTM, sikurse edhe me grupet e prekura dhe të interesuara, për t’iu dhënë atyre një arsyetim më të mirë rreth projektit dhe për të marrë opinionet dhe sugjerimet e tyre, për konsiderata të mëtejshme.

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

- Rishikimi i punës të kryer, mbas marrjes në konsideratë të komenteve të publikut dhe konsultimet me palët e interesuara, klientët e projektit, koordinatorin e projektit, etj, duke mbledhur, plotësuar dhe korigjuar të dhënat dhe/ose rezultatet dhe përgatitjen e raportit final.

Hapi i parë i Studimit Bazë ishte njohja me dokumentacionin e projektit, si dhe me "Kornizën Logjike" dhe fokusimi në objektivat e projektit, outputet (rezultatet), outputet (produktet), si dhe indikatorët dhe targetet përkatës. Mbledhja e të gjitha dokumenteve ekzistuese, lidhur me projektin si: Dokumentet e Thirrjes të Komunikimit të I, II dhe III Kombëtar, Plani i Menaxhimit të Kune Vain Tale, Strategjitë Kombëtare për Ujin, Bujqësinë, Pyjet, Strategjia e Integruar Mjedisore, Planet Kombëtare, Rajonale dhe Lokale lidhur me Kune Vain-in, legjislacioni përkatës për Zonat e Mbrojtura, Mjedisin, Përdorimin e Ujit, Projektligji për Zonat e Mbrojtura, reduktimi i varfërisë etj. Të dhënat shtesë mbi gjendjen mjedisore dhe socio-ekonomike u mblodhën në zyrat përkatëse të Bashkisë të Lezhës, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, zyrat statistikore të INSTAT në Lezhë dhe në Tiranë, etj. Për të marrë një opinion më të mirë rreth performancës të projektit u kryen intervista me organet administrative në nivel lokal/rajonale dhe kombëtar, lidhur me zbatimin e EbA. Nëpërmjet këtyre intervistave u identifikuan kapacitetet e tyre, aftësitë dhe njohuritë teknike të tyre, planet, buxhetet, autoritetet vertikal dhe horizontal, fokusi i tyre për zonën e mbrojtur Kune Vain, etj.

Burimet kryesore të administrimit të dokumentacionit zyrtar të nevojshëm ishin: zyra e Projektit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, IGJEUM Tiranë, Bashkia e Lezhës dhe Njësia Administrative Shëngjin, zyra e administrimit të Zonës të Mbrojtur Kune Vain, Agjencia Rajonale e Zonave të Mbrojtura dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, etj.

Konsulenti përfaqësues mbajti komunikim të vazhdueshëm me Udhëheqësin Këshilltar Teknik dhe Koordinatorin e Projektit për të siguruar që punët, detyrat dhe materialet e dorëzuara kishin cilësinë e duhur dhe ishin dorëzuar në kohën që ishte programuar.

Analizë dhe vlerësim i thellë u krye për secilin indikator të disponueshëm dhe targetin përkatës të secilit outcome dhe output. Në mënyrë që të sigurohej një dokument final, i një cilësie të mirë, të gjitha konstatimet u përfshinë në dokument, në mënyrën e duhur dhe duke marrë në konsideratë të kuptuarin si duhet për secilin output. Karakterizimi i indikatorëve dhe targeteve u analizua në detaje, me analiza reale të fokusuar në: arritjen, sjelljen ndër mend të nevojës për të rekomanduar ndryshime për indikatorët dhe targetet, në mënyrë që të sigurohej informacioni i duhur për outputet e zgjedhur. Gjithashtu, u siguroi se të gjithë indikatorët dhe targetet ishin SMART (Specifik, Të matshëm, të Arritshëm, të bazuar në Rezultate dhe të lidhur me Kufijtë kohor) me ndjeshmëri gjinore dhe me kosto efektive.

Të dhënat bazë u përzgjedhën në përputhje me indikatorët dhe targetet e projektit. Të dhënat u mblodhën, analizuan dhe pasqyruan në mënyrën e duhur shkencore, duke marrë parasysh metodologjitë ndërkombëtare, kuadrin kombëtar dhe politikat e UNEP-it. Prandaj, dokumenti i hartuar është një dokument i besueshëm, i gatshëm për t'u përdorur për zhvillimin e ardhshëm të projektit dhe si një rast studimi i përshtatshëm për projekte të ngjashme.

Identifikimi i mangësive të të dhënave ishte një pjesë e rëndësishme e punës të konsulentit. Keq-funksionimi ose mos-funksionimi i Organeve Administrative Kombëtare/Rajonale dhe Lokale në lidhje me EbA ishte një risk që u morr në konsideratë.

Bashkëpunimi me konsulentët e tjerë të projektit, në takime të për-javëshme ndihmuan konsulentin e Vëzhgimit Bazë në korrigjimin, vlerësimin dhe rivlerësimin e indikatorëve dhe targeteve të projektit.

4.5 Vlerësimi i Indikatorëve dhe targeteve

Të gjithë indikatorët e vlerësuar duke përdorur metodologjinë SMART, ishin me ndjeshmëri gjinore, lehtësisht të matshëm dhe me kosto efektive.

Specifik – Studimi kryesisht duhej të fokusohet në Sistemin Lagunor të Kune-Vain-it dhe të përcaktonte ndikimet e shkaktuara ose në dukje të shkaktuara nga ndryshimet e klimës. Vlerësimi i indikatorëve specifik të këtyre ndikimeve çoi në vlerësimin e targeteve përkatëse. Efektet e ndryshimeve klimatike në laguna kanë ndikimet e tyre në jetën sociale dhe ekonomike të komunitetit që jeton aty pranë, kështu që të gjithë indikatorët përkatës dhe multidisiplinor ishin të mirë fokusuar në komunitetin vendas, palët e interesuara, vendim-marrësit, etj. Pjesë e rëndësishme e kësaj detyre ishte përgatitja e tre tipe pyetësorësh të thjeshtuar, një që fokusohet tek komuniteti dhe një tjetër për palët e interesuara, si dhe një pyetësor i thjeshtë që do të shërbente për të vlerësuar nivelin e ndërgjegjësimit për qytetarët, lidhur me indikatorët dhe targetet. Nevojat dhe kërkesat e komunitetit dhe palëve të interesuara, kapacitetet administrative dhe institucionale dhe fokus grupet u konsideruan si çështja kryesore për rezultatet e projektit në lidhje me reduktimin apo përballjen ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike (erozioni, rehabilitimi i habitatit, etj). Plani vrojtues dhe intervistat u fokusuan në indikatorë dhe targete specifik.

I Matshëm – Indikatorët dhe efektet e tyre, dhe targetet u vlerësuan mbi karakteristikat e tyre të matshme, por gjithmonë duke pasur parasysh praktikën më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare. Konsulenti u siguroi që indikatorët ishin lehtësisht të matshëm, duke marrë parasysh thjeshtësinë, cilësinë dhe sasinë. Një metodologji fizike vlerësimi dhe një metodologji e thjeshtë vrojtimi u përdorën, duke pasur parasysh indikatorët biofizikë, indikatorët socio-ekonomik dhe ato administrativë.

I Arritshëm – Të gjithë indikatorët dhe targetet u vlerësuan mbi mundësinë e arritshmërisë të tyre, përcaktimin e matjeve, monitorimin dhe kontrollin e tyre. Kufizimet në buxhet dhe kohë u morrën në konsideratë për të vlerësuar efektshmërinë e kostos.

Real (I bazuar në rezultat) – U vlerësua se të gjithë indikatorët dhe targetet ishin të fokusuar në Kornizën e Rezultateve dhe ndërhyrjet e projektit, si dhe ishin në përputhje me planin e zonës dhe vektorët e zhvillimit. Gjithashtu, disponueshmëria, veçantia dhe nëse ishin ose jo të matshëm u morrën në konsideratë, me qëllim që të shmangeshin argumentet, konstatimet apo rezultatet teorike jo-efikase duke pasur parasysh fondet e reduktuara që mund të akordoheshin për matjet, studimet dhe monitorimet. Konsulenti ka vlerësuar nëse indikatorët dhe targetet tregojnë qartë arsyet, metodat dhe trendin e ndikimeve, si dhe ka paraqitur se kush, si dhe pse do të ndikohet; dhe si do të kontrollohen ndikimet negative ekzistuese dhe ato të pritshme. Dhe së fundi, nevojat e Zonës të Mbrojtur, si dhe nevojat dhe kërkesat e komunitetit, palëve të interesuara dhe vendim-marrësve u hartuan bashkërisht.

Koha – Duke marrë parasysh nevojën e menjëhershme për ndërhyrje, për shkak të ndryshimeve klimatike në vend, koha është konsideruar shumë e rëndësishme për efektshmërinë e projektit. Më në fund, monitorimi ose matjet janë propozuar që të realizohen për çdo sezon, ndërsa për disa indikatorë dhe targete ato janë planifikuar gjatë dy, tre ose më shumë sezona. Një manual kohe do duhet të paraqitet për të gjithë indikatorët dhe targetet e organeve monitorues dhe administrative. Konsulenti ka

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

vlerësuar kufijtë kohorë të të gjithë indikatorëve dhe targeteve për të siguruar një monitorim dhe vlerësim mjaft efikas dhe për të kontrolluar arritjet e planifikuara (në kohën e programuar).

Gjithashtu, indikatorët u vlerësuan e dhe në aspektin e ndjeshmërisë gjinore. Ky vlerësim u bazua në intervistat dhe takimet me komunitetin, palët e interesuara dhe vendim-marresit në nivele vertikale dhe horizontale.

Vlerësimi i efikasitetit të koston për secilin nga indikatorët, ishte pjesë e vlerësimit të indikatorëve. Të gjithë indikatorët u vlerësuan në bashkëpunim të ngushtë me konsulentët e tjerë të projektit, ekspertizën lokale dhe kombëtare, etj. Kështu që, rezultatet u përcaktuan edhe në bazë të konsultave të shumta dhe të efektshme.

Emri i kriterit	Kriteret/Tiparet	Konsiderata/Vlerësime
1	Specifik	Të gjithë indikatorët dhe targetet janë mjaft specifik dhe lehtësisht të identifikueshëm
2	I matshëm	Të gjithë indikatorët dhe targetet janë lehtësisht të matshëm
3	I arritshëm	Të gjithë indikatorët origjinal janë të arritshëm, përveç indikatorit 2.1.1 ¹⁾ , i cili tashmë është përjashtuar dhe pjesërisht indikatorët 2.1.2 ²⁾ , 2.1.4 ³⁾ , 2.3.1 ⁴⁾ , 2.3.3 ⁵⁾ , 3.3.2 (të cilët janë propozuar të ndryshohen pjesërisht)
4	I bazuar në rezultat	Të gjithë indikatorët janë lehtësisht të bazuar në rezultat, përveç indikatorëve 2.1.2 ²⁾ , 2.1.4, 2.3.1, 2.3.3, të cilët janë propozuar të ndryshohen pjesërisht
5	I lidhur me kufijtë-kohorë	Të gjithë indikatorët janë të lidhur me kohën, përveç indikatorëve 2.1.2, 2.1.4, 2.2.2, 2.3.1 dhe 2.3.3 të ndryshohen pjesërisht
6	Me ndjeshmëri gjinore	Të gjithë indikatorët dhe targetet janë me ndjeshmëri gjinore
7	Lehtësisht i matshëm	Të gjithë indikatorët dhe targetet janë lehtësisht të matshëm
8	Me kosto efektive	Të gjithë indikatorët dhe targetet janë me kosto efektive, përveç indikatorit 2.1.1 i cili është përjashtuar

Tabela 5 Konsideratat e vlerësimit të indikatorëve

¹⁾ - Indikatorit 2.1.1 – rihapja/hapja e 10 puseve artezian nuk është e arritshme sepse ujrat e nëntokës nuk kanë presion të mjaftueshëm për të arritur ujrat sipërfaqësore

²⁾ – Indikatorit 2.1.2 – mbjellja e 10 ha me pyje autoktone (vendase) është e arritshme vetëm për 7 ha, pasi nuk ka tokë të përshtatshme, të mjaftueshme për mbjellje.

³⁾ - Indikatorit 2.1.3 – Ekzistenca e një kanali të ri, komunikimi funksional midis lagunës të Cekës dhe detit Adriatik.

⁴⁾ - Targeti 2.2.2 – Numri i raporteve teknike të prodhuar, që detajojnë konstatimet e aktiviteteve të monitorimit të projektit

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpëmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

⁵⁾ – *Indikator 2.3.1 – Numri i anëtarëve të komunitetit lokal të trajnuar për EbA dhe mbi mënyrat tradicionale të jetësës, deri në fund të projektit.*

⁶⁾ – *Indikator 2.3.3 – Numri i anëtarëve të komunitetit vendas që kanë ndjekur trajnime mbi themelimin, financimin dhe funksionimin e sipërmarrjeve të ekoturizmit.*

⁷⁾ – *Targeti 3.3.2 – Numri i studentëve MSc dhe PhD që janë angazhuar në studime kërkimore/shkencore mbi ndikimet socio-ekonomike dhe mjedisore të ndërhyrjeve të zbatuara të EbA.*

Të gjithë elementët e përmendur më sipër janë vlerësuar sipas tabelës të mëposhtme, ku:

- a) Y- Po (yes), indikator është shumë i përshtatshëm,
- b) M- Mesatar (medium), indikator nuk është plotësisht i përshtatshëm dhe duhet të ndryshohet dhe
- c) N – Jo (No), indikator nuk është fare i përshtatshëm.

Indikatorët e vlerësuar në tabelën më poshtë duket se i plotësojnë të gjitha kërkesat e projektit dhe janë SMART. Indikator 2.1.1 dhe indikator 2.1.2, sikurse u shpjegua edhe më sipër nuk janë të arritshëm. Indikator 2.1.1, mund të arrihet vetëm duke përdorur një teknologjinë me pompim (puset mund të funksionojnë por jo me rrjedhje të lirë-arteziante), e cila nuk është efikase dhe rreziqet mund të shkaktojnë stres në komunitetin vendas ndërkohë që janë mësuar me kërkesat e tyre për ujë të pijshëm. Indikator 2.1.2 është gjysëm i arritshëm dhe jo i bazuar në rezultat, për shkak të kushteve të përdorimit të tokës, karakteristikave të tokës dhe zonimit të zonës ku do të aplikohet ripyllëzimi, sikurse është shprehur edhe nga ekspertët lokal dhe zyrtarizuar nga Projekti i Mbjelljeve. Indikator 2.1.4 u ndryshua në Raportin Teknik të Projektit të Mbjelljeve duke u bazuar në efikasitetin e ndërhyrjeve dhe duke marrë në konsideratë humbjen e habitateve, zonimin e Zonës të Mbrojtur dhe përdorimin e tokës në këtë zonë. Targeti i indikatorit 2.2.2 u ndryshua për arsye të kufizimit të afatit kohor të projektit (kanë ngelur vetëm dy vite deri në përfundimin e projektit dhe janë planifikuar të hartohen vetëm dy Raporte Teknike për secilin). Indikatorët 2.3.1 dhe 2.3.3 u vlerësuan si gjysëm të arritshëm, gjysëm të bazuar në rezultat dhe jo plotësisht të lidhur me kufijtë kohor për arsye të numrit relativisht të lartë, të personave që do të trajnohen për periudhën e mbetur për zbatimin e projektit. Indikator dhe targeti 3.3.2 u vlerësua gjithashtu, si gjysëm i arritshëm, për arsye të bllokimit të përkohshëm të programit të studimit PhD nga Qeveria Shqiptare.

Përfundimisht mund të thuhet se, përjashtimi i një prej indikatorëve të outputit dhe ndryshimi i disa të tjerëve, nuk ndikon në rezultatet e pritshme. Deri tani mund të konsiderohet se rezultatet janë shumë të përshtatshme për secilin vlerësim të komponentëve.

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

Outcomet dhe outputet	Indikatorët	Vlerësimi i Indikatorëve							
		Specifik	I Matshtëm	I Arritshëm	I bazuar në rezultat	Kufijtë kohorë	Me ndjeshmëri gjinore	Lehtësisht I matshtëm	Me kosto efektive
Outcome 1	1.1 Ndryshim në strukturën e vlerësimit të pikëve për kapacitetet e secilit institucion target.	Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y
Outputi i Outcome 1									
1.1	· 1.1.1 Numri i stafit të institucioneve qeveritare, të trajnuar · 1.1.2 Përqindja e femrave të trajnuara midis stafit të institucioneve qeveritare.	Y	y	Y	Y	Y	Y	Y	Y
1.2	· 1.2.1 Numri i udhëzuesve teknik të prodhuar për zbatimin e EbA. · 1.2.2 Numri i stafit të institucioneve qeveritare të trajnuar mbi përdorimin e udhëzuesve teknik të zbatimit të EbA. · 1.2.3 Përqindja e femrave midis stafit qeveritar të trajnuar mbi përdorimin e udhëzuesve teknik për zbatimin e EbA.	Y Y	Y Y	Y Y	Y Y	Y Y	Y Y	Y Y	Y Y
1.3	· 1.3.1 Grupi Teknik i punës për ndryshimet klimatike dhe EbA themeluar dhe funksional në kuadër të grupit ndër-ministror të punës për ndryshimet klimatike. · 1.3.2 Përqindja e femrave në grupin teknik të punës për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe EbA. · 1.3.3 Plani i mobilizimit të fondeve për zbatimin në shkallë të gjerë të EbA i zhvilluar.	Y Y Y	Y Y Y	Y Y Y	Y Y Y	Y Y Y	Y Y Y	Y Y Y	Y Y Y
1.4	· 1.4.1 Numri i dokumentave draft të strategjive të përshkallëzimi të prodhuar për të përmirësuar, mbështetur dhe përgjigjur zhvillimit të kapaciteteve për tu përshtatur ndaj ndryshimeve të klimës, duke përdorur EbA.	Y	y	Y	Y	Y	Y	Y	Y
Outcome 2	2.1 Ndryshimi në përqindje të pikëve të indeksit të vulnerabilitetit të ndryshimeve klimatike.	Y Y	Y Y	Y Y	Y Y	Y Y	Y Y	Y Y	Y Y

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

	2.2 Numri i anëtarëve të komunitetit të cilët kanë rritur të ardhurat e tyre përmes iniciativave tradicionale të jetesës. 2.3 Përqindja e femrave midis anëtarëve të komunitetit të cilët kanë rritur të ardhurat e tyre përmes iniciativave tradicionale të jetesës.	Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y
Outputi i Outcome 2									
2.1	-2.1.1 Numri i puseve artezianë në funksionim, në pjesën e lagunës Zaje dhe Ceka të sistemit lagunor Kune-Vain, si dhe shkarkimi i ujit të ëmbël në lagunë. -2.1.2 Hektarët e pyjeve bregdetarë të degraduar, që do të ripyllëzohen me lloje të qëndrueshme ndaj ndryshimit të klimës sipas protokolleve teknik. - 2.1.3 Ekzistenca e një kanali të ri komunikimi dhe funksional midis lagunës të Cekës dhe detit Adriatik. - 2.1.4 Rehabilitimi sipas protokolleve teknik, i një gjatësie prej 2000 m të dunave bregdetare, me lloje të qëndrueshme ndaj ndryshimit të klimës.	Y	Y	N	Y	Y	Y	Y	N
		Y	Y	M	Y	Y	Y	Y	Y
		Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y	M
		Y	y	M	M	M	Y	Y	Y
2.2	-2.2.1 Zhvillimi i një strategjie afatgjatë për monitorimin e ndërhyrjeve EbA, në sistemin lagunor Kune-Vain. -2.2.2 Numri i raporteve teknik të prodhuar, që detajojnë rezultatet e aktiviteteve të monitorimit të projektit.	Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y
		Y	y	Y	Y	M	Y	Y	Y
2.3	-2.3.1 Numri i anëtarëve të komunitetit lokal të trajnuar për EbA dhe mjetet tradicionale të jetesës përfshirë ekoturizmin, deri në fund të projektit. -2.3.2 Përqindja e femrave midis anëtarëve të komunitetit lokal të trajnuar për Eba dhe mjetet tradicionale të jetesës, përfshirë ekoturizmin. -2.3.3 Numri i anëtarëve të komunitetit që kanë ndjekur trajnime mbi themelimin, financimin dhe funksionimin e sipërmarrjeve potenciale të ekoturizmit.	Y	Y	M	M	M	Y	Y	Y
		Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y
		Y	y	M	M	M	Y	Y	Y
Outcome 3	3.1 Ndryshimi në përqindje të banorëve (në nivel kombëtar) që kanë njohuri rreth rreziqeve klimatike si dhe potencialit të EbA për të rritur kapacitetet përshtatëse të komunitetit vendas. 3.2 Ndryshimi në përqindje të banorëve në rajonin e Lezhës, që kanë njohuri rreth rreziqeve të ndryshimeve klimatike dhe potencialit të EbA për të rritur kapacitetet për përshtatje të komunitetit vendas. 3.3 Numri i raporteve/dokumentave shkencor të publikuara në një revistë	Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y
		Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y
		Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y
		Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

	akademike në lidhje me ndikimet socio-ekonomike të ndërhyrjeve EbA të zbatuara. 3.4 Numri i dokumentave të shkarkuar nga platforma e bazuar në web								
Outputet e Outcome 3									
3.1	·3.1.1 Zhvillimi i një plani menaxhimi të njohurive dhe një strategjie komunikimi	Y	y	Y	Y	Y	Y	Y	Y
3.2	·3.2.1 Numri i fushatave të mbajtura për rritjen e njohurive dhe shkëmbimin e eksperiencave mbi EbA.	Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y
3.3	·3.3.1 Numri i raporteve/dokumentave shkencor të prodhuar, mbi ndikimet socio-ekonomike të ndërhyrjeve EbA, të zbatuara.	Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y
	·3.3.2 Numri i studentëve MSc dhe PhD që kanë ndërmarrë studime kërkimore mbi ndikimet socio-ekonomike të ndërhyrjeve të zbatuara, të EbA.	Y	Y	M	Y	Y	Y	Y	Y
3.4	·3.4.1 Platforma e bazuar në web për të shkëmbyer informacion mbi EbA e zhvilluar dhe në funksionim.	Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y

Tabela 6 Vlerësimi i indikatorëve bazuar në metodologjinë SMART (me shkronjën “N” dhe ngjyrë të kuqe tregohet indikator i cili është vlerësuar si jo i përshtatshëm, me shkronjën “M” dhe ngjyrë blu tregohen indikatorët që janë vlerësuar si të përshtatshëm, por që kanë nevojë për disa ndryshime në cilësi dhe/ose sasi dhe me shkronjën “Y” dhe ngjyrë të zezë tregohen indikatorët e vlerësuar si të përshtatshëm.)

4.6 Rezultatet e vlerësimit të indikatorëve dhe targeteve

Një vlerësim i detajuar u krye për secilin nga outcomet e projektit dhe outputet përkatës, duke marrë në konsideratë indikatorët, vlerat bazë dhe targetet.

Në tabelën e vlerësimit janë paraqitur: indikatorët, outputet dhe targetet origjinal (ekzistues) dhe ata të rekomanduar. Në përgjithësi, outcomet pasqyrohen me outputet, indikatorët dhe targetet e duhur. Sikurse u shpjegua edhe në kapitullin më sipër, vetëm indikatorit 2.1.1 (hapja/rihapja e puseve artezianë) është përjashtuar për arsye objektive dhe indikatorit 2.1.2 (ripyllëzimi) është reduktuar nga 10 ha në 7 ha. Disa ndryshime janë propozuar edhe për indikatorët 2.3.1 dhe 2.3.3. Disa ndryshime janë propozuar edhe për targetin e indikatorit 2.2.2 dhe targetin e indikatorit 3.3.2. Gjithashtu, ndryshime të vogla janë propozuar për targetet kombëtar/rajonat/lokal, të kushtëzuara ngë krijimi i grupit ndër-ministror të punës për ndryshimet klimatike, gjatë viteve të fundit. Ndryshime të tjera shtesë mund të kushtëzohen nga ndryshimet në emër apo përgjegjësi të institucioneve target. Muajin e kaluar, me krijimin e strukturës të re qeveritare, Ministria e Mjedisit u bashkua me Ministrinë e Turizmit, dhe sot njihet si Ministria e Mjedisit dhe Turizmit. Ndërkohë, Ministria e Zhvillimit Urban u shkri në Ministri të ndryshme dhe tashmë nuk ekziston më. Ndryshime të tilla mund të ndodhin me krijimin e reformave edhe për Agjensinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Agjensinë Kombëtare të Bregdetit, Agjensinë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjensinë e Planifikimit Territorial, etj. dhe këto mund të pasqyrohen në targetet e Vëzhgimit Bazë që janë të lidhur me administratën.

Objektivi i projektit është: Të rriten kapacitetet e qeverisë dhe të komunitetit lokal që jeton pranë SLKV, për tu përshtatur ndaj ndryshimeve të klimës duke përdorur një tërësi të integruar ndërhyrjesh të përshtatjes, përfshirë EbA.

Konsulentit ka shqyrtuar të gjitha dokumentat e lidhur me të, ka përcaktuar aktorët në të gjitha nivelet e institucioneve, si dhe ka kontaktuar sa më shumë të ishte e mundur, personat e caktuar për tu kontaktuar. Informacion shtesë u grumbullua nga intervistat me institucionet kërkimore, institucionet arsimore, familjet, shkencëtarët dhe studiuesit individual, etj, për të përfutur një pasqyrë më të mirë për kapacitetet e qeverisë dhe të komunitetit lokal që jeton pranë SLKV, si dhe për të vënë në dukje ndërhyrjet e përshtatjes dhe tendencën e këtyre kapaciteteve.

Sikurse dhe u përmend në nën-kapitullin 4.1, “Përshkrimi i Vëzhgimit Bazë” u intervistuan përfaqësues të 32 institucioneve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Kriteret për të përcaktuar statusin e objektivit, u orientuan në outcomet dhe outputet e lidhur me të. Informacioni bazë i kërkuar, fokusohet në 5 pyetje të drejtpërdrejta (tanimë, e përgjithësuar në tabelën 8).

1. A ka subjekti informacion mbi ekzistencën e ndonjë politike apo plani për të identifikuar rreziqet nga ndryshimet klimatike, si dhe strategjitë dhe masat e duhura për tu përshtatur? – Nëse përgjigja ishte pozitive, duhet të pyetet edhe nëse; institucioni në fjalë kishte marrë pjesë në hartimin, konsultimin apo trajnimin për këto politika apo plane, etj. Informacion shtesë u kërkua për institucionet/subjektet që kishin marrë pjesë në hartimin e dokumentave të tillë ose që kishin dijeni për të tilla dokumente.

2. A i është dhënë prioritet dhe a janë specifikuar masat dhe strategjitë e përshtatjes me akordime në buxhet dhe targete?

3. A përcakton politika apo plani role dhe përgjegjësi të qarta për koordinimin dhe zbatimin e masave dhe strategjive të përshtatjes?

4. A garanton politika apo plani monitorim, vlerësim, studim dhe rishikim të vazhdueshëm të masave dhe strategjive të përshtatjes?

5. A ka të dhëna të zbatimit efikas të politikës apo planit?

Pyetje të tilla u pasuan me të tjera pyetje, të cilat u detajuan në outcomet dhe outputet e tyre, të lidhura drejtpërdrejt me objektivin. Të 5 pyetjet e drejtuara u fokusuan më tepër në outcome 1, pasi ato ishin hartuar për të reflektuar më mirë nivelin e kapaciteteve kombëtar/rajonale dhe lokale për të adresuar rreziqet e ndryshimeve klimatike dhe për përshtatjen sipas EbA. Për më shumë detaje referohuni tabelës nr.8.

Outcome 1 i projektit e vë theksin tek: “Rritja e Kapaciteteve Kombëtare dhe Institucionale për adresimin e rreziqeve të shkaktuara nga ndryshimet klimatike në Zonat Bregdetare nëpërmjet ndërhyrjeve të përshtatjes, duke përfshirë EbA”.

Organizatat dhe institucioneve kryesore ku konsultimet ishin produktive për Raportin e Vëzhgimit bazë ishin 32 subjektet e listuara si poshtë:

1. Ministria e Mjedisit (MM) – Tiranë, aktualisht Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)
2. Drejtoria e Zonave të Mbrojtura dhe Biodiversitetit, MM, Tiranë
3. Drejtoria e Administrimit të Ujrave, Sektori i Ndryshimeve Klimatike, MM, Tiranë
4. Zyra e Projekteve, Bashkia Lezhë
5. Drejtoria Rajonale e Zonave të Mbrojtura, Lezhë
6. Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Lezhë
7. Departamenti i Integritit dhe Zhvillimit Rajonal, Këshilli i Qarkut Lezhë
8. Agjensia e Menaxhimit të Pyjeve, Bashkia Lezhë
9. Këshilli i Qarkut, Lezhë
10. Drejtoria e Arsimit, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve, Bashkia Lezhë
11. Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Qarku Lezhë
12. Agjensia Rajonale e Zhvillimit, Bashkia Lezhë
13. Drejtoria Rajonale e Edukimit, Bashkia Lezhë
14. Njësia Administrative Shenkoll, Bashkia Lezhë
15. Njësia Administrative Shengjin, Bashkia Lezhë
16. Ecological club, Lezhë (OJF)
17. Administrata e Zonës të Mbrojtur Kune-Vain
18. Ministria e Shëndetësisë, Tiranë
19. Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë
20. Ministria e Energjisë, Tiranë
21. Ministria e Planifikimit Urban, Tiranë
22. Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Tiranë
23. Sekretariati Kombëtar i Ujrave, Kryeministria, Tiranë
24. Universiteti Bujqësor i Kamzës, Tiranë
25. Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, Tiranë
26. GIZ Albania, bashkë-rezultues në projektin e Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike, në Ballkanin Perëndimor
27. Agjensia Kombëtare e Bregdetit
28. Fakulteti i Shkencave Gjeologjike, Universiteti Politeknik i Tiranës
29. Muzeu i Shkencave të Natyrës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës
30. Departamenti i Inxhinierisë të Mjedisit, Fakulteti i Inxhinierisë të Ndërtimit, Tiranë
31. Akademia Shqiptare e Shkencave, Tiranë
32. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Tiranë

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

Pyetjet e orientuara ndaj institucioneve të përmendura më sipër (sikurse tregohet edhe në tabelën 8) janë si më poshtë:

1. A ka marrëveshje institucionale për të adresuar ndryshimet klimatike në zonat bregdetare?
Nga intervistat me përfaqësuesit e institucioneve target rezultoi se për shumicën e institucioneve kombëtare dhe SMKVT nga institucionet lokale ka marrëveshje për të adresuar ndryshimet klimatike në Zonat Bregdetare.
2. A janë këto marrëveshje të bazuara në mandate të forta dhe të qarta?
Marrëveshje të reja janë vendosur pas zgjedhjes të Qeverisë të re në Qershor, të vitit 2017. Ende nuk është e qartë nëse reformat e ardhshme të qeverisë të re do të ndikojnë pozitivisht ose jo në mandatin e institucioneve target.
3. A janë këto marrëveshje të mbështetura me akordim buxheti të përshtatshëm?
Për shkak të ndryshimeve në institucionet qeveritare të paraqitura më sipër, nuk është ende e qartë se si do të akordohet buxheti për ndryshimet klimatike dhe EbA.
4. A përfshijnë këto marrëveshje pjesëmarrjen e grupeve të interesit të të gjithë sektorëve të lidhur apo të prekshëm nga ndryshimet e klimës?
Sikurse dhe për pyetjet 2 dhe 3, ende nuk është e qartë nëse do të ketë vazhdimësi ose jo të trendit të pjesëmarrjes të të gjitha grupeve të interesit midis sektorëve të përkatës, të prekshëm nga ndryshimet klimatike.

Për më shumë detaje referohuni tabelës nr. 8.

Në këtë drejtim u ndërmorr edhe një përqasje e gjerë sektoriale. Një sërë strategjish ndër-sektoriale në nivel kombëtar, që fokusohen në zonat bregdetare kanë filluar ose janë përfunduar. Një përmbledhje e fushës të mbuluar në secilën nga strategjitë ndër-sektoriale ekzistuese për përshtatjen nga ndryshimet klimatike është paraqitur në tabelën e mëposhtme. Sidoqoftë, ndryshimet e kohëve të fundit në Qeverinë Shqiptare, mbas zgjedhjes të Qershorit, 2017 mund të rezultojnë me ndryshime në institucionet përgjegjëse apo të lidhur me ndryshimet klimatike (të përmendura në këtë raport si targetet institucionale kombëtare).

Vlerat e outcome 1 të projektit janë pasqyruar nga vlerësimi i outputeve të tij, referuar si më poshtë:

1.1 Trajnime të kryera në lidhje me EbA për përfaqësuesit qeveritarë në nivel kombëtar dhe lokal. Ky output duket sikur është në fazën e parë të zhvillimit. Disa seminare, në lidhje me ndryshimet klimatike por shumë sipërfaqësor për sa i përket EbA ishin organizuar në nivel kombëtar, po ashtu edhe për grupin e punës ndër-ministror si dhe për Agjensitë Kombëtare ose Agjensitë Rajonale dhe Institucionet përkatëse. Sidoqoftë, duhet të zhvillohen edhe më shumë trajnime, në mënyrë që të shtrihet edhe më gjerë koncepti mbi EbA në nivele lokal dhe për institucionet operative që merren me zbatimin e saj. Në Lezhë, vetëm një numër i vogël institucionesh si; Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura dhe Stafi i Menaxhimit të Kune Vain-it deklaruan se kanë ndjekur disa trajnime të përgjithshme rreth ndryshimeve klimatike.

1.2 Udhëzuesit teknik të prodhuar për zbatimin e ndërhyrjeve të përshtatjes nëpërmjet EbA, si dhe trajnimet e zhvilluara mbi përdorimin e këtyre udhëzuesve. Në tabelën e mëposhtme janë përfshirë disa nga Strategjitë Ndër-Sektoriale dhe deri në çfarë niveli këto strategji kanë përfshirë masat specifike për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, po ashtu edhe fushat e lidhura në mënyrë indirekte me këto masa, të cilat në shumicën e rasteve nuk mbulohen. Udhëzuesit realë ende mungojnë, por Qeveria Shqiptare në përgjithësi përdor udhëzuesit e UNFCCC.

Komunikimi i Tretë Kombëtar, draft dokumenti tashmë i përfunduar, ka të përfshirë në terma të përgjithshëm EbA në zonat bregdetare dhe duket si strategjia më e mirë deri më sot, lidhur me politikat

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpëmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

dhe ndërhyrjet e bazuara në EbA. Sidoqoftë, kjo strategji nuk mund të konsiderohet si e mirë fokusuar
mbi ndërhyrjet nëpëmjet EbA.

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpëmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

Fokusi	Strategjitë Ndër-sektoriale							
	Strategjia e Shëndetësisë	Strategjia e Energjisë	Strategjia e Bujqësisë	Strategjia Ndër-sektoriale e Mjedisit 2015-2020	Grykëderdhja e Lumenjve Drini dhe Mati	Komunikimi i Parë Kombëtar	Komunikimi i Dytë Kombëtar	Komunikimi i Tretë Kombëtar
Orientimi i procesit të përshtatjes në Shqipëri	+	+	+	-	+	+	+	+
Iniciativat e integritit gjithëpërfshirës	+	+	+	-	+	+	+	+
Gatishmëria e financave për klimën	-	-	-	-	-	-	+	+
Zbatimi i sistemit të monitorimit	+	•	+	+	+	+	•	+
Sistemi i informacionit të përshtatjes për Shqipërinë (GIS)	+	•	+	-	-	+	+	+
Iniciativat për komunikim dhe informim	+	•	+	+	•	+	+	+
Nismat për zhvillimin e kapaciteteve për përshtatjen ndaj ndryshimeve	+	•	+	+	+	+	+	+

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpëmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

klimatike								
Plani i Veprimit i Integruar me menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet	●	-	+	-	+	+	+	+
Plani i Veprimit i integruar me menaxhimin e rrezikut nga thatësira	●	-	+	-	+	+	+	+
Plani i Veprimit për menaxhimin e bregdetit	-	-	●	-	+	+	+	+
Përshtatja në menaxhimin e burimeve ujore	●	●	+	+	+	+	+	+
Nismat për përshtatjen e Bashkëve	+	-	-	-	+	+	+	+
Veprimet themelore për përshtatjen në Bujqësi	●	+	+	+	+	+	+	+
Veprimet themelore për përshtatjen në sektorin e pyjeve	-	●	+	+	+	+	+	+
Veprimet themelore për	+	+	●	+	●	+	+	+

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

përshtatjennë sektorin e Energjisë								
Veprimet themelore për përshtatjen në sektorin e shëndetësisë	+	•	•	+	•	+	+	+
Veprimet themelore për përshtatjen në sektorin e turizmit	•	•	•	-	+	+	+	+
<ul style="list-style-type: none"> + Strategjitë e përfunduara (Përveç Komunikimit të Tretë, i cili është ende në fazën e hartimit (draft) dhe merr në konsideratë EbA) • Planet e Veprimit të përfunduar ose që tashmë kanë filluar, të cilët janë marrë pjesërisht në konsideratë në këto strategji, por që ende nuk janë përfunduar. - Tregon që këto veprime nuk janë të përfshira në strategjitë përkatëse. 								

Tabela 7 Iniciativat Ndër-sektoriale që marrin në konsideratë ndryshimet klimatike dhe EbA

Megjithëse këto strategji apo Plane Veprimi mund të konsiderohen si udhëzues të përgjithshëm, udhëzimet teknike ende mungojnë. Aktualisht, Shqipëria përdor udhëzimet ndërkombëtare.

1.3. Grupi Teknik i Punës, i fokusuar konkretisht në EbA për të lehtësuar bisedimet kombëtare mbi përshtatjen e bregdetit nëpërmjet EbA dhe për të mobilizuar fonde, për zbatimin e EbA në nivel kombëtar nuk është krijuar ende. Grupi Ndër-ministror i Punës, tashmë i krijuar me urdhër të Kryeministrit, në datë 25.04.2014 është në funksion që nga viti 2016. Krijimi dhe funksionimi i grupit ndër-ministror të punës sipas detyrave të bashkërenduara ngë Ministrinë është bërë sipas detyrimeve të shtetit Shqiptar në Konventën e Kombeve të Bashkuara në Kuadër të Ndryshimeve Klimatike (UNFCCC) dhe në përputhje me nenin 108 të Marrëveshjes të Stabilizim-Asocimit (SAA).

Grupi ndër-ministror i Punës kryesohet nga Zëvendësministri i Mjedisit dhe përbëhet si më poshtë:

- 3 (tre) përfaqësues të Ministrisë të Mjedisit (aktualisht Ministria e Turizmit dhe Mjedisit)
- 2 (dy) përfaqësues nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë
- 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
- 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë
- 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve
- 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Punëve të Jashtme
- 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave
- 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Integritimit Europian
- 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Financave
- 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme
- 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit (e ndryshuar më vonë si Ministria e Ekonomisë dhe Turizmit dhe aktualisht e shkrirë në ministrinë e tjera përkatëse.
- 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore

Sikurse u përmend edhe më sipër, përbërja e grupit ndër-ministror të punës mund të ndryshojë sipas Marrëveshjeve të reja Qeveritare.

1. Grupi ndër-ministror i punës duhet të:

- a) Të hartojë politika dhe strategji për ndryshimet klimatike dhe duhet ti përfshijë ato në planet përkatës sektorial;
- b) Nxitë dhe harmonizojë bashkëpunimin ndër-institucional për zbatimin e planeve dhe startegjive për ndryshimet klimatike në sektorët përkatës; dhe të informojë rregullisht Kryeministrin mbi zhvillimet në këto sektorë.
- c) Të kontribuojë në pjesëmarrjen e Republikës të Shqipërisë në Konferencën e Palëve të UNFCCC, takimet e Bashkimit Europian dhe forumet ndërkombëtare dhe rajonale. Të gjitha këto kontribute duhet të dorëzohen nëpërmjet Ministrisë të Punëve të Jashtme;
- d) Të identifikojë të gjitha mundësitë për lehtësimin, promovimin, vlerësimin dhe sipas rastit të shprehë opinionin e tyre rreth projekteve që reduktojnë emetimin e gazeve me efekte serrë dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;
- e) Të miratojë një plan pune për vitin kalendarik dhe ta pasqyrojë atë në mënyrë periodike.

2. Në varësi të çështjes të takimit, Kryetari i grupit ndër-ministor të punës fton gjithashtu të marrin pjesë në takime dhe përfaqësues nga institucionet e tjera në nivel qendror dhe lokal, përfaqësues të shoqërisë civile, akademikët dhe ekspertët me eksperiencë në çështjet e ndryshimeve klimatike.
3. Grupi ndër-ministor i Punës duhet të zhvillojë takime, jo më pak se 2 herë në vit. Gjithashtu, duhet të marrë pjesë në takimet speciale, sipas kërkesës të kryetarit. Çdo anëtar i grupit duhet të konsultohet me kryetarin për takimet jashtë programit. Vendimet e grupit ndër-ministor të punës duhet të merren me konsensus dhe të nënshkruhen nga kryetari. Ministri i Mjedisit dhe/ose Ministrinë e tjera duhet të informohen mbi vendimet, sipas temës.
4. Sekretariati teknik që do të punojë me grupin e punës, do të ketë detyrat e mëposhtme:
 - a) Të informojë anëtarët e grupit ndër-ministor të punës rreth takimeve të posaçme, të planifikuara;
 - b) Të përgatitë një program të takimeve, bazuar në programin fillestar të punës;
 - c) Të kujdeset për çështjet logjike, për organizimin e takimeve, të mbajë procesverbalin e takimeve dhe të koordinojë zbatimin e detyrave të grupit të punës, në kohë;
5. Funkcionet e Sekretariatit Teknik duhet të ekzekutohen nga drejtoria përgjegjëse për ndryshimet klimatike.

Përsa i përket fondit të mobilizimit, një dokument financiar është parashikuar në Planin Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP). Plani Kombëtar për Përshtatje (NAP) tashmë është hartuar, por ende nuk është miratuar. Në dokumentin kryesor janë përfshirë hapa të ndryshëm, sikurse janë përshkruar edhe më poshtë:

- Hapat për përfshirjen e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe NAP në Programin e Buxhetit afat-mesëm dhe afatgjatë dhe për forcimin e kuadrit dhe proceseve institucionale, lidhur me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.
- Ngritja e kapaciteteve për zhvillimin e projektit, korigjimin e klimës, planifikimin, programimin, teknikat për llogaritjen e kostos, analizën e kosto-përfitimit dhe kosto-efektivitetit dhe financat për klimën.
- Hapat për të vendosur zbatimin e sistemit të monitorimit dhe monitorimin e bazuar në rezultat.
- Identifikimi i projektit dhe përgatitja e projekt-propozimeve
- Hapat për themelimin e procesit të mobilizimit të burimeve për financat e klimës.

NAP nuk specifikon ndonjë dokument financimi për ndonjë zhvillim shtesë të EbA, përveç fondeve të zhvilluara për projektin në fjalë.

1.4. Mbështetja teknike që do të ofrohet për zhvillimin e një strategjie për të përmirësuar, mbështetur dhe replikuar zhvillimin e qëndrueshëm ndaj klimës, bazuar në EbA ende nuk është zhvilluar. Dokumenti kryesor strategjik në lidhje me EbA mbetet Thirrja e Komunikimit të Tretë Kombëtar. Ky dokument u zhvillua në Projektin “Miratimi i Aktiviteteve për Përgatitjen e Komunikimit të Tretë Kombëtar” në kuadër të Konventës të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, e zbatuar nga Ministria e Mjedisit dhe Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), me mbështetje financiare të Faciliteti Global i Mjedisit (GEF). Ndër të tjera, në dokument janë përfshirë:

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

- Statusi Kombëtar
- Inventari i emetimit të gazeve serrë (GHG inventory)
- Vlerësimi i vulnerabilitetit dhe përshtatjes
- Analizimi i Zbutjes
- Analizimi i Sektorit të Energjisë
- Analizimi i Zbutjes për Sektorët e Bujqësisë dhe Blegtorisë
- Analizimi i Zbutjes për Sektorin e Pyjeve
- Analizimi i Zbutjes në Sektorin e Mbetjeve
- Hapat e ndërmarrë ose të parashikuar për të zbatuar Konventën

Outcome 2, fokusohet në; “Reduktimi i Vulnerabilitetit për komunitetet që jetojnë pranë Sistemit Lagunor Kune-Vain, ndaj ngjarjeve ekstreme të shkaktuara nga ndryshimet klimatike nëpërmjet ndërhyrjeve pilot të përshtatjes, duke përfshirë EbA. Disa ndryshime janë sugjeruar për outputet përkatëse, pas konsultave me Konsulentin Teknik të ndërhyrjeve dhe VNM. Outcome 2 i referohen outputet e mëposhtme:

2.1 Një komplet i integruar i ndërhyrjeve të përshtatjes, duke përfshirë EbA, të zbatuara në sistemin lagunor Kune Vain. Ndërhyrje të tilla, konsistojnë në: hapjen/rihapjen e 10 puseve artezianë, mbjelljen e 10 hektare me pyje autoktone (vendase), mbjelljen e 2 hektar me shkurre dhe barishte bregdetare dhe hapja e kanalit të komunikimit midis lagunës Ceka dhe detit Adriatik. Këto outpute kanë disa ndryshime, sipas përfundimeve të rezultuara nga projekti teknik. Sipas raportit të projektit inxhinierik, “gjatë 20 viteve të fundit është vënë re një rënie e presionit të ujit deri në atë pikë sa uji i nëntokës nuk mund të arrijë në sipërfaqen e tokës, sikurse ndodhte para viteve 90’. Shkaqet e ndryshme që kanë ndikuar në rënien e presionit të ujit, janë listuar më poshtë:

1. Pakësimi i sasisë të ujit që furnizohet nga akuiferet
2. Dëmtimet ose bllokimet e shkaktuara përgjatë aksit të puseve
3. Krijimi artificial i burimeve dhe mbipërdorimi i tyre për qëllime alternative

Nga verifikimet e mëtejshme rezultoi se zvogëlimi i sasisë të ujit furnizues nga akuiferet mund të duket i pranueshëm gjatë periudhave të thata. Normalisht, me kalimin e sezonit të thatësirës uji do të dilte sërish në sipërfaqen e tokës, por aktualisht një dukuri e tillë nuk ndodh në ditët e sotme.

Më pas, pasi u kryen kontrole të mëtejshme në puset e padëmtuar dhe jo të bllokuar, u qartësua se edhe në këto burime të shëndosha niveli i ujit qëndronte 50 cm poshtë sipërfaqes të tokës.

Për më tepër, zona përreth u shqyrtua edhe gjatë kërkimit të informacionit në lidhje me ndërhyrjet e mundshme, ndoshta të krijuara vitet e fundit, dhe rezultoi se ishin kryer dy shpime pranë zonës të lagunës, me shumë mundësi të kryera nga anëtarë të komunitetit lokal, për të siguruar ujin.

Pasojë e drejtpërdrejtë e këtyre ndërhyrjeve për qëllim të sigurimit të ujit është ulja deri në -1.10m e presionit të ujrave nëntokësorë.

Kështu që si përfundim, aktiviteti për hapjen e puseve artezianë nuk mund të kryhet. (Për më shumë detaje, referohuni raportit teknik të Projektit Inxhinierik për outputin ‘hapja/rihapja e puseve artezian dhe hapja/rihapja e kanalit të komunikimit det/lagunë).

Gjithashtu, duke ju referuar raportit teknik për mbjelljet u arrit në rezultat se nuk ka tokë të përshtatshme për mbjelljen e 10 ha pyje. Për këtë arsye sipërfaqja që do të ripyllëzohet do të reduktohet në 7 hektar. Mbjellja në territore të tjera të zonës nuk është e mundur për arsye të përbërjes të tokës dhe statusit të mbrojtjes. Gjithashtu, sërish duke ju referuar raportit teknik për mbjelljet, sipërfaqja që do të mbillet me shkurre dhe barishte do të përfshijë jo vetëm dunat bregdetare, por edhe

bregun e lumit Drin, si dhe vende të tjera të përshtatshme. Ky ndryshim është justifikuar me rehabilitimin e habitateve specifike, të humbura si pasojë e efekteve të klimës, duke i konsideruar mbjelljet me barishte dhe shkurre autoktone, jo vetëm si një instrument për stabilizimin e dunave por edhe si një habitat bazë, të rëndësishëm për kafshët e egra, të veçanta për Zonën e Mbrojtura (për më shumë detaje, ju lutem referojuni raportit teknik për mbjelljet). Kjo ndërhyrje është justifikuar gjithashtu edhe me përdorimin e tokës të zonës të mbrojtur, sikurse dhe është propozuar në Planin e Menaxhimit të Zonës të Mbrojtur.

2.2. Strategji afat-gjatë për: i) zhvillimin e monitorimit të ndërhyrjeve me bazë EbA; dhe ii) përgatitjen e raporteve teknike. Një strategji afat-gjatë për monitorimin e ndërhyrjeve të bazuara në EbA është zhvilluar në këtë raport, ndërsa raporte teknike të përgatitura, nuk janë zhvilluar ende.

2.3. Trajnimi i komunitetit lokal për EbA and mjetet tradicionale të jetesës, duke përfshirë ekoturizmin. Vëzhgimi në terren, intervistat dhe takimet me familjarët, treguan se ende nuk është zhvilluar asnjë lloj trajnimi për komunitetin lokal në lidhje me EbA dhe mjetet tradicionale të jetesës. Disa trajnime të përgjithshme janë zhvilluar për stafin e Administrimit të Kune-Vain-it dhe Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura, por asnjë prej tyre nuk paraqiti ndonjë dokumentacion mbi këto trajnime. Me sa duket, trajnimet e familjarëve nga ekspertët ndërkombëtar apo kombëtar, për projekte të ngjashme nuk kanë qënë shumë frytdhënës. Trajnimi i një numri të vogël ekspertësh të administratës, në nivel lokal OJF-të, etj, nga ekspertë kombëtar dhe ndërkombëtar do të ndihmojë krijimin e bazave për shpërndarjen e njohurive mbi EbA dhe ekoturizmin në nivel lokal/rajonale. Këta ekspertë do të jenë në shërbim të projektit në vazhdim ose për projekte të tjera në të ardhmen, si trajnues për familjet në fusha të ndryshme të ekonomisë, po ashtu edhe bujqësisë dhe ekoturizmit, të cilët janë ndikuar negativisht nga ndryshimet klimatike. 10 prej këtyre trajnuesve mund të trajnohen mbi praktikën e ndryshme të zbatimit të EbA në bujqësi dhe 10 trajnues të tjerë mund të trajnohen mbi instrumentat, mekanizmat, kapacitetet dhe potencialet e ekoturizmit, duke marrë në konsideratë efektet e ndryshimeve klimatike dhe fokusin mbi potencialin e pritshëm turistik të zonës. Në këtë mënyrë u propozua një reduktim i numrit të komunitetit lokal të trajnuar (20 persona krahasuar me 50 të propozuar nga rezultatet e studimit të mëparshëm), dhe trajnimi duhet të fokusohet mbi problemet dhe nevojat e zonës, kapacitet natyrore dhe humane dhe karakteristikat, kulturën vendase dhe strategjitë kombëtare/rajonale.

Outcome tre (3) fokusohet në “Rritjen e njohurive të palëve të interesuara lokale dhe kombëtare ndaj rreziqeve të ndryshimeve klimatike, si dhe potencialit të EbA për të rritur kapacitetet e përshtatjes të komunitetit lokal ndaj ndryshimeve klimatike”. Të gjithë outputet e këtij outcome janë SMART, por aktualisht nuk është ndërmarrë asnjë lloj aktiviteti apo fushatë ndërgjegjësuese për qëllime të tilla.

3.1 Plan Menaxhimi i zhvilluar që mban dhe shpërndan informacion mbi ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe mësimet e nxjerra për të informuar mbi ndërhyrjet e ardhshme, të bazuara në EbA. Ende nuk ka ndonjë plan menaxhimi të zhvilluar për ndërhyrjet e EbA, në të ardhmen.

3.2 Fushatat e zhvilluara për rritjen e njohurive mbi avantazhet e EbA në rritjen e kapaciteteve për t’u përshtatur ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Në rajonin e Lezhës është zhvilluar një fushatë ndërgjegjësimi mbi ndikimet e ndryshimeve klimatike, rreth dy vjet më parë, nga UNDP, por kjo fushatë nuk ishte e fokusuar mbi EbA. Outputi 3.2 ka si qëllim zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuese, të fokusuara veçanërisht për EbA.

3.3. Raportet teknike të përgatitur mbi performancën e zbatimit të ndërhyrjeve, të bazuara në EbA dhe projekte studimore/kërkimore nuk janë zhvilluar ende për aq kohë sa veprimet e ndërhyrjeve nuk janë zbatuar akoma. Por këto outpute dhe targete duken si të përshtatshëm, duke marrë parasysh periudhën në të ardhmen. Janë zhvilluar një numër i caktuar artikujsh shkencorë dhe PhD lidhur me ndryshimet

klimatike, në Universitetin e Tiranës, por vetëm një prej tyre është e fokusuar drejtpërdrejt në ndërhyrjet me bazë EbA. Ky indikator pritet që të zhvillohet në një fazë të mëtejshme.

3.4. Një platformë e bazuar në web është krijuar për të shpërndarë informacion dhe për të bërë të mundur aksesin ndaj produkteve të projektit. Ky output është nën zbatimin e zyrës të projektit dhe pritet që të zhvillohet së shpejti.

Secili nga outcome, si dhe outputet dhe indikatorët përkatës mund të zbatohet lehtësisht, por është e nevojshme një mbështetje e fortë nga ana e autoriteve kombëtare, rajonale dhe lokale.

Tabela më poshtë (Tabela Nr. 7) tregon vlerat bazë origjinale të indikatorëve dhe targeteve dhe për secilin indikator dhe output të caktuar janë paraqitur ndryshimet e propozuara, bashkë me shpjegimet përkatëse.

Shumica e targeteve duken të përcaktuar qartë, por duhet të kryhet një vlerësim më i mirë, në një fazë të mëvonshme lidhur me fokusin e shumicës të përfaqësuesve të grupit ndër-ministror të punës dhe institucioneve kërkimore/shkencore përkatëse. Disa prej indikatorëve janë shkrirë, në mënyrë që të lehtësohet vlerësimi aktual dhe në të ardhmen, pa dëmtuar fokusin e studimit bazë, rëndësinë, domethënien e indikatorëve dhe efikasitetin e targeteve.

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpëmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

Objektivi	Original			I Rekomanduar			Mënyrat e verifikimit
	Indikatorët	Vlerat Bazë	Targetet	Indikatorët	Vlerat Bazë	Targetet	
Të rritet kapaciteti i qeverisë dhe komunitetit lokal që jeton pranë SLKV, për tu përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike duke përdorur një komplet të integruar ndërhyrjesh të përshtatjes, përfshirë Eba.	Ndryshimet në kapacitetet e institucioneve kombëtare, rajonale dhe nën-rajonale për identifikimin, dhënien e prioritetit, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e masave dhe strategjive të Eba janë forcuar.	Rezultati: 4 pikë Qeveria dhe komuniteti lokal që jeton pranë sistemit lagunor KVLS kanë pjesërisht kapacitete për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike (Vlerat bazë të kapaciteteve u vlerësuan gjatë verifikohen më tej, gjatë fazës fillestare të projektit). Nuk është kryer ndonjë vlerësim nga stafi qeveritar ose komuniteti lokal për kapacitetin e përshtatjes	Rezultatit: 8 pikë Institucionet kombëtare, rajonale dhe nënrajonal kanë zhvilluar në masë të gjerë kapacitetet për të identifikuar, dhënë prioritet, zbatuar, monitoruar dhe vlerësuar, masat dhe strategjitë e Eba.	I njëjtë si origjinali. Ndryshimet në kapacitetet e institucioneve kombëtare, rajonale dhe nën-rajonale për identifikimin, dhënien e prioritetit, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e masave dhe strategjive të Eba janë forcuar.	Totali i pikëve: 3 1. Institucionet qeveritare dhe komuniteti lokal që jeton pranë SLKV kanë pjesërisht kapacitete për tu përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike. Vetëm 36.8 % , nga 100 % e përfaqësuesve të institucioneve kombëtare/lokale (të përfaqësuar nga punonjës të Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë të Energjisë, Ministrisë të Shëndetësisë, Ministrisë të Zhvillimit Urban, Institutit të Shëndetit Publik, Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe Zyrës Rajonale të Administrimit të Zonave të Mbrojtura) të intervistuar, u shprehën se planet/politikat për identifikimin e rreziqeve të ndryshimeve klimatike, si dhe masat dhe strategjitë e përshtatjes, aktualisht ekzistojnë në masë të gjerë. Një Plan për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike është përgatitur për Bashkinë e Tiranës. Përfaqësuesit e tjerë të intervistuar nuk janë të informuar mbi të tilla strategjie apo plane. 2. Masat dhe strategjitë e përgjithshme për përshtatje mbeten të zhvilluara vetëm në nivel kombëtar (me disa përjashtime në rajonin e Lezhës dhe Shkodrës) dhe akordimi i fondeve po ashtu mbetet në të njëjtat nivele, por ende nuk është i mirë-përcaktuar dhe i fokusuar në masa specifike. Vetëm 3.1% (përfaqësuesit e Ministrisë të Mjedisit) deklaruan se buxheti për masat dhe strategjitë për përshtatje është akorduar dhe specifikuar, po ashtu edhe targetet. Përfaqësuesit e tjerë të institucioneve, të intervistuar nuk kishin informacion mbi këtë çështje. 3. Rolet dhe përgjegjësitë për bashkërendimin dhe zbatimin e masave dhe strategjive të përshtatjes janë të mirë përcaktuara. Vetëm 36.8% (përfaqësuesit e MTM, Ministrisë të	Totali i pikëve: 8 I njëjtë si origjinali Institucionet kombëtare, rajonale dhe nën-rajonale kanë zhvilluar në masë të gjerë kapacitetet për të identifikuar, dhënë prioritet, zbatuar, monitoruar dhe vlerësuar, masat dhe strategjitë e Eba.	Verifikuar sipas metodologjise të llogaritjes të pikëve, të rekomanduar sipas AMAT, përshtatur nga TAMD (2013) dhe PPCR (2014) Indikatori bazohet në 5 kriteret të paraqitura në formë pyetjesh: 1. A ka politika apo plane për identifikimin e rreziqeve ndaj ndryshimeve klimatike si dhe masat dhe strategjitë e duhura për përshtatje? 2. A janë specifikuar dhe prioritetizuar këto masa dhe strategji të përshtatjes me akordimin e buxhetit dhe targetet? 3. A përcaktojnë këto politika/plane role dhe përgjegjësi të qarta për bashkërendimin dhe zbatimin e masave dhe strategjive për përshtatje? 4. A parashikojnë politikat/planet monitorimin e vazhdueshëm, vlerësimin, mësimin dhe rishikimin e masave dhe strategjive

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpëmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

				<p>Energjisë, Ministrisë të Shëndetësisë, Ministrisë të Zhvillimit Urban, Institutit të Shëndetit Publik, Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe një përfaqësues i SMKV (Administratës Rajonale të Zonës të Mbrojtur) u shprehën pozitivisht rreth kësaj pyetje. Përfaqësuesit e institucioneve të tjerë nuk kishin informacion mbi përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi rreth kësaj çështje.</p> <p>4. Vetëm përfaqësuesit e Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit deklaruan se planet/strategjitë të cilat parashikojnë monitorim të vazhdueshëm, vlerësim, mësim dhe rishikimi të masave dhe strategjive të përshtatjes ekzistojnë në shkallë të gjerë.</p> <p>5. Nuk ka evidenca mbi zbatimin e politikave/planeve të efektshme.</p> <p>Tabela më poshtë paraqet 5 kriteret e shprehura si pyetje, si dhe pikët përkatëse të indikatorit të objektivit, bazuar në konsultat me përfaqësuesit e institucioneve target.</p>	<p>për përshtatje?</p> <p>5. A ka të dhëna mbi zbatimin efikas të kriterëve të palneve/politikave? Çdo pyetje ka marrë një vlerësim me pikë për sa i përket shtrirjes në të cilën kriteri përkatës është përmbushur: Aspak (= 0), pjesërisht (= 1) ose në masë të gjerë/plotësisht (= 2). Një total pikësh është llogaritur, me një maksimum pikësh prej 10, nga 5 kriteret e dhëna.</p>																		
				<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th rowspan="2" style="text-align: left;">Kriteret e vlerësimit të indikatorit të objektivit</th> <th colspan="3" style="text-align: center;">Pikët</th> </tr> <tr> <th style="text-align: center;">0</th> <th style="text-align: center;">1</th> <th style="text-align: center;">2</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="font-size: small;">A ka politika apo plane për identifikimin e rreziqeve ndaj ndryshimeve klimatike si dhe masat dhe strategjitë e duhura për përshtatje?</td> <td style="text-align: center;">Aspak</td> <td style="text-align: center;">Pjesërisht</td> <td style="text-align: center;">Në masë të gjerë/plotësisht</td> </tr> <tr> <td style="font-size: small;">A janë specifikuar dhe prioritzuar këto masa dhe strategji për përshtatje me akordimin e buxhetit dhe targeteve?</td> <td style="text-align: center;">Aspak</td> <td style="text-align: center;">Pjesërisht</td> <td style="text-align: center;">Në masë të gjerë/plotësisht</td> </tr> <tr> <td style="font-size: small;">A përcaktojnë këto politika/plane role dhe përgjegjësi të qarta për bashkërendimin dhe zbatimin e masave dhe strategjive për përshtatje?</td> <td style="text-align: center;">Aspak</td> <td style="text-align: center;">Pjesërisht</td> <td style="text-align: center;">Në masë të gjerë/plotësisht</td> </tr> </tbody> </table>	Kriteret e vlerësimit të indikatorit të objektivit	Pikët			0	1	2	A ka politika apo plane për identifikimin e rreziqeve ndaj ndryshimeve klimatike si dhe masat dhe strategjitë e duhura për përshtatje?	Aspak	Pjesërisht	Në masë të gjerë/plotësisht	A janë specifikuar dhe prioritzuar këto masa dhe strategji për përshtatje me akordimin e buxhetit dhe targeteve?	Aspak	Pjesërisht	Në masë të gjerë/plotësisht	A përcaktojnë këto politika/plane role dhe përgjegjësi të qarta për bashkërendimin dhe zbatimin e masave dhe strategjive për përshtatje?	Aspak	Pjesërisht	Në masë të gjerë/plotësisht
Kriteret e vlerësimit të indikatorit të objektivit	Pikët																						
	0	1	2																				
A ka politika apo plane për identifikimin e rreziqeve ndaj ndryshimeve klimatike si dhe masat dhe strategjitë e duhura për përshtatje?	Aspak	Pjesërisht	Në masë të gjerë/plotësisht																				
A janë specifikuar dhe prioritzuar këto masa dhe strategji për përshtatje me akordimin e buxhetit dhe targeteve?	Aspak	Pjesërisht	Në masë të gjerë/plotësisht																				
A përcaktojnë këto politika/plane role dhe përgjegjësi të qarta për bashkërendimin dhe zbatimin e masave dhe strategjive për përshtatje?	Aspak	Pjesërisht	Në masë të gjerë/plotësisht																				

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpëmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

					A parashikojnë politikat/planet monitorimin e vazhdueshëm, vlerësimin, mësimin dhe rishikimin e masave dhe strategjive për përshtatje?	Asp ak	Pjesëris ht	Në shkallë të gjerë/ plotësisht		
					A ka të dhëna mbi zbatimin efikas të kritereve të këtyre palneve/politikave?	Asp ak	Pjesëris ht	Në shkallë të gjerë/ plotësisht		
<i>Komente objektivin për</i>	<p>Rezultatet e Objektivit janë të mirë-përcaktuara dhe lehtësisht të arritshme pavarësisht ndryshimeve të bëra për disa nga indikatorët e outputeve. Ekzistojnë vetëm dy plane strategjik (një prej të cilëve nuk është aprovuar ende), Thirrja e Komunikimit të Tretë Kombëtar për Ndryshimet Klimatike dhe NAP, të cilat përsa i përket zonës në studim mbeten të përgjithshme. Këto dokumenta draft përcaktojnë rreziqet e ndryshimeve klimatike në terma të përgjithshëm dhe nuk paraqesin masa të detajuara të përshtatjes për zonën dhe për EbA. Konsulenti ka kryer një vlerësim të kujdesshëm duke respektuar afatin kohor dhe buxhetin në dispozicion, duke intervistuar të gjithë aktorët e mundshëm për përgatitjen dhe vlerësimin e planeve/strategjive, lidhur me EbA. Ky vlerësim është bazuar në intervistat e këtyre aktorëve, ose të tjerëve të lidhur me këto dokumentacione, në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar, sikurse është referuar edhe në kapitujt e mëparshëm.</p> <p>Raporti i Vëzhgimit Bazë nxorri përfundimin se Autoritetet Kombëtare kanë pjesërisht kapacitete për identifikimin, dhenie përparësie, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e strategjive të EbA, por është e nevojshme të zhvillohen më shumë trajnime në nivel lokal (autoritetet lokale dhe grupet e interesit).</p> <p>Targeti është shumë i qartë dhe i mirë përcaktuar</p>									
Outcome 1	Original			I rekomanduar			Mënyrat e Verifikimit			
	Indikatorët	Vlerat Bazë	Targetet	Indikatorët	Vlerat Bazë	Targetet				
Rritja e kapaciteteve teknike dhe institucionale lokale/kombëtare për të adresuar rreziqet e ndryshimeve klimatike në zonat bregdetare, nëpërmjet ndërhyrjeve të përshtatjes, bazuar në EbA.	Indikatori 1.1. Ndryshim në kuadrin e vlerësimit me pikë të kapaciteteve për secilin nga institucionet target.	Vlerat Bazë 1.1 Vlerat bazë të përcaktuara gjatë vlerësimit të vëzhgimit bazë duke përdorur kriterin e pikëve sipas AMAT.	Targeti 1.1. Secili institucion target (Ministria e Mjedisit – qeveria kombëtare, Këshilli i Komunës Lezhe- qeveria lokale, Administrata e Zonës të Mbrojtur Laguna e Kune-Vain-Tale, etj.) kanë avancuar me një minimum prej 1 pikë në kuadër të vlerësimit me pikë të kapacitetit të tyre.	Indikatori 1.1. Mbetet i njëjtë si origjinali. Ndryshimi në kuadrin e vlerësimit me pikë të kapaciteteve për secilin nga institucionet target.	Vlerat Bazë 1.1 Totali i pikëve: 2 Vlerat bazë të përcaktuara gjatë vlerësimit të vëzhgimit. 44% nga përfaqësuesit e institucioneve target të intervistuar (shumica e të cilëve nga institucionet kombëtare dhe vetëm një përfaqësues nga institucionet lokale – Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura) u përgjigjën se ekzistojnë marrëveshje institucionale për adresimin e ndryshimeve klimatike, dhe se këto marrëveshje janë të bazuara në mandate të qarta dhe të forta. Vetëm përfaqësuesit e MTM, Ministrisë të Planifikimit Urban dhe SMKVT deklaruan se këto marrëveshje janë të mbështetura me akordim të mjaftueshëm buxheti. Këto marrëveshje institucionale nuk përfshijnë plotësisht pjesëmarrjen e grupeve të interesit. Vetëm 12.5% e tyre (MTM, Ministria e Planifikimit Urban, MSH, SMKVT) deklaruan se	Targeti 1.1. Secili institucion target (Ministria e Mjedisit –qeveria kombëtare, Këshilli i Komunës Lezhe- qeveria lokale, Administrata e Zonës të Mbrojtur Laguna e Kune-Vain-Tale, etj.) kanë avancuar me një minimum prej 1 pikë në kuadër të vlerësimit me pikë të kapacitetit të tyre.	Metodologjia e llogaritjes, e sugjeruar dhe rishikuar sipas GEF AMAT. Llogaritja është bazuar në katër kritere të shprehura si pyetje (këto kritere do të jenë të vlefshme më tej edhe për fazën fillestare): 1. A ka marrëveshje institucionale për të adresuar ndryshimet klimatike në zonat bregdetare? 2. A janë këto marrëveshje të bazuara në mandate të forta dhe të qarta? 3. A janë këto			

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpëmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

					<p>këto marrëveshje përfshijnë pjesëmarrjen e palëve të interesuara midis sektorëve përkatës, të lidhur me ndryshimet e klimës. Tabela e mëposhtme paraqet vlerësimin e indikatorëve të outputit bazuar sipas metodologjisë të AMAT.</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th rowspan="2" style="background-color: #D3D3D3;">Kriteret e vlerësimit të indikatorit të outputit</th> <th colspan="3" style="background-color: #D3D3D3;">Pikët</th> </tr> <tr> <th style="background-color: #D3D3D3;">0</th> <th style="background-color: #D3D3D3;">1</th> <th style="background-color: #D3D3D3;">2</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="background-color: #D3D3D3;">A ka marrëveshje institucionale për të adresuar ndryshimet klimatike në zonat bregdetare?</td> <td style="background-color: #ADD8E6;">Aspak</td> <td style="background-color: #ADD8E6;">Pjesërisht</td> <td style="background-color: #ADD8E6;">Në masë të madhe/plotësisht</td> </tr> <tr> <td style="background-color: #D3D3D3;">A janë këto marrëveshje të bazuara në mandate të forta dhe të qarta?</td> <td style="background-color: #ADD8E6;">Aspak</td> <td style="background-color: #ADD8E6;">Pjesërisht</td> <td style="background-color: #ADD8E6;">Në masë të madhe/plotësisht</td> </tr> <tr> <td style="background-color: #D3D3D3;">A janë këto marrëveshje të mbështetura me akordim të mjaftueshëm buxheti?</td> <td style="background-color: #ADD8E6;">Aspak</td> <td style="background-color: #ADD8E6;">Pjesërisht</td> <td style="background-color: #ADD8E6;">Në masë të madhe/plotësisht</td> </tr> <tr> <td style="background-color: #D3D3D3;">A përfshijnë këto marrëveshje pjesëmarrjen e palëve të interesuara midis sektorëve përkatës, të ndjeshëm ndaj klimës?</td> <td style="background-color: #ADD8E6;">Aspak</td> <td style="background-color: #ADD8E6;">Pjesërisht</td> <td style="background-color: #ADD8E6;">Në masë të madhe/plotësisht</td> </tr> </tbody> </table>	Kriteret e vlerësimit të indikatorit të outputit	Pikët			0	1	2	A ka marrëveshje institucionale për të adresuar ndryshimet klimatike në zonat bregdetare?	Aspak	Pjesërisht	Në masë të madhe/plotësisht	A janë këto marrëveshje të bazuara në mandate të forta dhe të qarta?	Aspak	Pjesërisht	Në masë të madhe/plotësisht	A janë këto marrëveshje të mbështetura me akordim të mjaftueshëm buxheti?	Aspak	Pjesërisht	Në masë të madhe/plotësisht	A përfshijnë këto marrëveshje pjesëmarrjen e palëve të interesuara midis sektorëve përkatës, të ndjeshëm ndaj klimës?	Aspak	Pjesërisht	Në masë të madhe/plotësisht	<p>marrëveshje të mbështetura me akordim të mjaftueshëm buxheti? 4. A përfshijnë këto marrëveshje pjesëmarrjen e palëve të interesuara midis sektorëve përkatës, të lidhur me ndryshimin e klimës? Secila pyetje është përgjigjur me një vlerësim dhe me pikë, për shkallën në të cilën është përmbushur kriteri: Aspak (= 0), pjesërisht (= 1) ose në një masë të madhe/plotësisht (= 2). Një total i pikëve të vlerësimit është llogaritur, me një maksimum të pikëve – 8, nga 4 kriteret e dhëna.</p>
Kriteret e vlerësimit të indikatorit të outputit	Pikët																												
	0	1	2																										
A ka marrëveshje institucionale për të adresuar ndryshimet klimatike në zonat bregdetare?	Aspak	Pjesërisht	Në masë të madhe/plotësisht																										
A janë këto marrëveshje të bazuara në mandate të forta dhe të qarta?	Aspak	Pjesërisht	Në masë të madhe/plotësisht																										
A janë këto marrëveshje të mbështetura me akordim të mjaftueshëm buxheti?	Aspak	Pjesërisht	Në masë të madhe/plotësisht																										
A përfshijnë këto marrëveshje pjesëmarrjen e palëve të interesuara midis sektorëve përkatës, të ndjeshëm ndaj klimës?	Aspak	Pjesërisht	Në masë të madhe/plotësisht																										
Komentet	e	Rezultatet e outcome 1 janë të arritshme dhe të përcaktuara mirë, edhe pas ndryshimeve në disa indikatorë të outputeve. Marrëveshjet institucionale për adresimin e ndryshimeve klimatike																											

Ndërtimi për Rikuperimin e Sistemit Lagunor Kune - Vain nëpëmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem
– Vëzhgimi
Bazë

Outcome 1	<p>në zonat bregdetare janë arritur, por pritet që gjatë kësaj kohe të ndodhin ndryshime, me krijimin e qeverisë të re. Mandatet e disa institucioneve (si p.sh. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Bregdetit etc., nuk janë shumë të qarta, me marrëveshjet e reja. Me sa duket marrëveshjet institucionale në funksion, nuk përfshijnë pjesëmarrje të palëve të interesit.</p> <p>Institucionet target mund të ndryshojnë si rezultat i ndryshimeve në Marrëveshjet Administrative të Qeverisjes Lokale dhe Qëndrore. Një verifikim i vazhdueshëm i ndryshimeve të tilla do të ndihmojë për përditësimin e targeteve, nëse do të jetë e nevojshme për pasojë të ndryshimeve të përmendura më sipër. Krijimi i Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit në vend të Ministrisë të Mjedisit si një autoritet kombëtar specifik mund të pasqyrojë ndryshime në kapacitetet e MTM në lidhje me ndryshimet klimatike dhe EbA.</p>						
Outputet Outcome 1	Original			I rekomanduar			Mënyrat e Verifikimit
	Indikatorët	Vlerat Bazë	Targetet	Indikatorët	Vlerat Bazë	Targetet	Mënyrat e Verifikimit
1.1. Kryerja e trajnimeve për përfaqësuesit e qeverisë lokale dhe kombëtare, për EbA	1.1.1 Numri i stafit qeveritar të trajnuar për të identifikuar, dhënë prioritet, zbatuar, monitoruar dhe vlerësuar strategjitë dhe masat e EbA.	Vlerat bazë: 0	Të paktën 30 pjesëmarrës të stafit qeveritar nga ministrinë përkatëse dhe institucionet qeveritare lokale, të trajnuar për të identifikuar, prioritetizuar, zbatuar, monitoruar dhe vlerësuar masat dhe strategjitë e EbA.	1.1.1 Numri i stafit qeveritar të trajnuar për të identifikuar, dhënë prioritet, zbatuar, monitoruar dhe vlerësuar strategjitë dhe masat e EbA.	Vlerat bazë: Dy përfaqësues të stafit qeveritar, (përfaqësues të MTM) janë pjesërisht të trajnuar për të identifikuar, dhënë prioritet, zbatuar, monitoruar dhe vlerësuar strategjitë dhe masat e EbA. .	Të paktën 30 pjesëmarrës të stafit qeveritar nga ministrinë përkatëse dhe institucionet qeveritare lokale, të trajnuar për të identifikuar, prioritetizuar, zbatuar, monitoruar dhe vlerësuar masat dhe strategjitë e EbA.	1.1.1. Raporte që detajojnë seancat e trajnimit dhe mbledhjeve, duke përfshirë listën e prezencës (të verifikuar në fund të çdo seance trajnimi). Çertifikata të pjesëmarrjes në trajnimet ndërkombëtare brenda ose jashtë Shqipërisë
	Koment për Indikatorin 1.1.1 dhe targetin përkatës		<p>Vetëm dy përfaqësues nga Ministria e Mjedisit janë trajnuar për identifikimin, prioritetizimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e masave dhe strategjive të EbA. Nuk ka përfaqësues të institucioneve të tjera qëndrore dhe lokale, të trajnuar për EbA.</p> <p>Një numër i konsiderueshëm përfaqësuesish nga stafi i qeverisë kombëtare, përfshirë ministrinë e linjës dhe institucione të tjera kombëtare kanë marrë pjesë në trajnimet për rreziqet klimatike, masat zbutëse, etj, por jo për EbA.</p> <p>Targeti është mjaft real.</p>				
